



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

# RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI GJETJET DHE REKOMANDIMET E MONITORIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

14 maj 2023

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



**RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI GJETJET DHE REKOMANDIMET E MONITORIMIT TË  
ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

**14 maj 2023**

Nisma “Ndërtimi i integritetit elektoral dhe qëndrueshmërisë së partive politike: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe kërkesave të qytetarëve nëpërmjet mbështetjes së OShC-ve, mediave dhe akademisë”, mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë

**Publikuar në 19 Shtator 2023**

# **Raport përfundimtar mbi gjetjet dhe konkluzionet e Monitorimit të Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore**

## **Përgatiti:**

Znj. Anda Kruetani, Koordinatorë Projektesh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

## **Përgatiti Kapitullin 8 mbi dekriminalizimin:**

Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Menaxhere Projektesh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

## **Mbikëqyrën dhe rishikuan:**

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky raport është hartuar në kuadër të nismës “Ndërtimi i integritetit elektoral dhe qëndrueshmërisë së partive politike: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe kërkesave të qytetarëve nëpërmjet mbështetjes së OShC-ve, mediave dhe akademisë”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në partneritet me Instituti i Studimeve Politike, Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania, mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Tiranë.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike në Tiranë.

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt”

Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Cel: +355 69 40 75 732

E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al)

Web site: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)

## TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje.....	- 4 -
Përmbledhja Ekzekutive .....	- 5 -
1. Veprimtaria e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore .....	- 8 -
2. Publikimi i Listave dhe Njoftimi me Shkrim i Zgjedhësve .....	- 8 -
3. Administrimi i Procesit Zgjedhor.....	- 9 -
a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	- 9 -
b. Ngritja dhe funksionimi i Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) .....	- 11 -
c. Ngritja e Komisioneve të Qendrave të Votimit .....	- 12 -
d. Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV).....	- 13 -
4. Fushata zgjedhore.....	- 13 -
a. Shtirirja e fushatës së parakohshme.....	- 13 -
b. Klima e fushatës zyrtare.....	- 14 -
c. Mbulimi mediatik.....	- 15 -
d. Përdorimi i burimeve shtetërore .....	- 16 -
e. Krimet Zgjedhore.....	- 18 -
5. Dekriminalizimi.....	- 18 -
6. Respektimi i heshtjes zgjedhore .....	- 19 -
7. Procesi i Votimit.....	- 20 -
a. Klima dhe Rendi Publik .....	- 20 -
b. Hapja e procesit të votimit.....	- 21 -
c. Funksionimi i pajisjeve të votimit elektronik.....	- 21 -
d. Rregullshmëria e procesit të votimit.....	- 22 -
e. Aksesi në ushtrimin e detyrës së vëzhguesit .....	- 23 -
f. Mbyllja e procesit të votimit.....	- 24 -
8. Procesi i Numërimit.....	- 24 -
a. Klima e përgjithshme e procesit .....	- 24 -
b. Rregullshmëria e procesit të numërimit.....	- 24 -
c. Numërimi elektronik pranë Bashkisë Elbasan .....	- 25 -
d. Klasifikimi i vlefshmërisë së votave .....	- 25 -
e. Mbyllja e procesit të numërimit të votave.....	- 25 -
9. Shpallja e rezultateve dhe Ankimimet .....	- 26 -
Rekomandime.....	- 27 -
Falenderime .....	- 29 -

## HYRJJE

---

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është një organizatë jofitimprurëse, themeluar më 16 dhjetor 1990. Misioni i KShH është të kontribuojë në respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit ligjor, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë pas Dekretimit të Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore nga Presidenti i Republikës<sup>1</sup>, KShH u angazhua për monitorimin e tyre. Në muajin Mars të këtij viti, KQZ miratoi listën prej 30 vëzhguesish afatgjatë të KShH-së, të cilët shtrinë monitorimin në 14 Bashki të Vendit, përkatësisht në Shkodër, Dibër, Malësi e Madhe, Kukës, Lezhë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Pogradec, Korçë, Fier, Berat, Vlorë dhe Gjirokastrë. Pas akreditimit të tyre nga KQZ, vëzhguesit ju nënshtruan dy trajnimeve, të cilat synuan rritjen e kapaciteteve mbi aspektet teorike dhe praktike të lidhura me legjislacionin zgjedhor dhe metodologjinë e monitorimit, e cila bazohet në parimet e objektivitetit, verifikimit, dhe profesionalizmit.

*KShH falenderon dhe i është mirënjohës të gjithë vëzhguesve afatgjatë dhe korrespondentëve vendorë për profesionalizmin, paanshmërinë, integritetin dhe përkushtimin e tyre.*

Përveç monitorimit në terren nga korrespondentët e vëzhguesit afatgjatë, të udhëzuar dhe të mbështetur drejtpërdrejt nga stafi ekzekutiv i KShH-së, të dhënat që i kanë shërbyer raporteve paraprake të monitorimit dhe këtij raporti përfundimtar janë mbështetur gjithashtu në monitorimin e faqeve zyrtare *online* të institucioneve, ndjekjen e seancave apo mbledhjeve të KQZ-së, kërkesat për informacion drejtuar institucioneve dhe sinjalizimet dhe perceptimet e qytetarëve të anketuar në terren në 14 Bashkitë e vendit.

Monitorimi u realizua me mbështetjen financiare të Ambasadës Britanike në Tiranë, nëpërmjet nismës “Ndërtimi i integritetit elektoral dhe qëndrueshmërisë së partive politike: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe kërkesave të qytetarëve nëpërmjet mbështetjes së OShC-ve, mediave dhe akademisë”. Nisma po zbatohet nga një konsorcium organizatash vendase, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti i Studimeve Politike, Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

---

<sup>1</sup> Dekreti nr. 1386, datë 24.10.2022

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

---

- Pas Zgjedhjeve për Kuvend të 25 Prillit 2021, Kuvendi ngriti Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore me qëllimin për të kryer ndryshimet përkatëse në Kodin Zgjedhor, mbështetur kryesisht në rekomandimet e OSBE/ODIHR. Në fakt, ky Komision në katër mbledhjet e realizuara nuk pati asnjë rezultat konkret, kështu që në Zgjedhjet e 14 Majit 2023 u zbatua Kodi Zgjedhor, i plotësuar me ndryshimet e bëra ndaj tij më 23.07.2021 dhe 05.10.2020.
- Nga monitorimi i zbatimit të publikimit në kohë të listave të zgjedhësve sipas pikës 3 të nenit 56 të Kodit Zgjedhor, rezultoi se në disa Bashki, përkatësisht Bashkia Durrës, Lezhë, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë dhe Elbasan kishte mungesa apo mospublikime të tërësishme të listave sipas afateve të caktuara. Gjithashtu, KShH vijoi të konsiderojë me shqetësim se listat fizike të zgjedhësve vijnë në pozicionin në vende të cilat krijojnë vështirësi në aksesin e votuesve.
- KQZ ka lehtësuar qasjen e vëzhguesve në monitorimin e punës së tyre intensive nëpërmjet transmetimit *live* të mbledhjeve të kryera në kanal *YouTube* të institucionit. Gjithsesi, vendimet, urdhërat e udhëzimet e miratuara dhe sidomos procesverbalet shoqëruese të këtyre mbledhjeve, shpesh herë janë publikuar me vonesa të konsiderueshme në faqen zyrtare të *web-it* të KQZ-së, duke shkaktuar pengesa në shqyrtimin e mirëfilltë të tyre dhe reagimin e shpejtë të aktorëve monitorues.
- Pavarësisht se në një numër më të shtuar në raport me zgjedhjet e kaluara, vendimmarrjet e KQZ për ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore nuk ishin gjithmonë rezultat i një hetimi efektiv (brenda afateve), parashikuan sanksione simbolike e jo proporcionale, si dhe u vunë re qëndrime të ndryshme të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe KAS, duke sjellë në disa raste favorizimin e subjekteve zgjedhore apo institucioneve që ishin në kushet e ndalimit.
- Komisioneri miratoi Vendimin nr. 421, datë 03 Maj 2023, bazuar në një prej denoncimeve të përcjella nga KShH, nëpërmjet të cilit u vendos ndalimi i postimeve apo ripostimeve në rrjetet sociale të një institucioni publik të aktiviteteve të cilat pasqyrohen në profilin personal të drejtuesit të institucionit publik. Edhe pse KShH përshëndeti precedentin pozitiv që krijoi kjo vendimmarrje, KShH gjithashtu informoi KQZ-në se gjatë verifikimeve të mëtejshme kishte konstatuar vijimin e ripublikimit të aktiviteteve në mediat sociale. KQZ edhe pse e mirëpriti këtë informacion nuk arriti të konkretizojë shkeljen e mësipërme.
- Pavarësisht masave paraprake të ndërmarra nga Prokuroria e Përgjithshme dhe KQZ për zbatimin e procesit të dekriminalizimit<sup>2</sup>, gjatë periudhës zgjedhore Maj 2023 rezultoi se procesi i verifikimit të të dhënave të pasqyruara në formularët e vetëdeklarimit ende nuk kishte përfunduar. KShH, gjithashtu, konstaton me shqetësim se asnjë prej partive politike nuk ka ushtruar të drejtën për të kërkuar verifikim të thelluar për kandidatët e mundshëm të tyre, duke treguar mungesë interesi për rëndësinë që ka zbatimi efektiv dhe në kohë i këtij ligji.
- Ligji për partitë politike<sup>3</sup> përmban rregullime që avantazhojnë ndihmën financiare të partive të mëdha, të cilat përfitojnë nga ky fond për shkak se përmbushin në të njëjtën kohë disa prej kritereve të kërkuara. Në vlerësimin e KShH, shpërndarja e fondeve duhet të jetë proporcionale sepse siç vërehet edhe në Vendimin nr. 309 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve<sup>4</sup>, dy partitë më të mëdha politike marrin afërsisht 75% të fondit të buxhetit të shtetit. Kjo formulë vlen të rishikohet nga organi legjislativ duke vendosur kritere objektive që mundësojnë shpërndarjen e drejtë dhe

---

<sup>2</sup> Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

<sup>3</sup> Nr. 8580, dt. 17.02.2002, i ndryshuar deri në vitin 2017 (neni 19/2)

<sup>4</sup> <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Vendimi-309-date-12.04.2023-Per-shperndarjen-e-fondeve-vjetore-partive-politike-ne-formen-e-ndihmes-financiare-vjetore-per-vitin-2023-1-1.pdf>

proporcionale sipas një kategorizimi që nëse një parti përfiton një shumë të caktuar nën njërin prej kritereve ligjore, nuk mundet të jetë po ashtu përfituese njëkohësisht nën kriteret e tjera.

- Gjerësisht, u vu re se subjektet zgjedhore të cilat mund të propozojnë komisionerë të KQV-ve përcollën listat vetëm në ezaurim të afatit të caktuar<sup>5</sup> dhe përgjithësisht këto lista kanë qënë të paplotësuara prej tyre me dokumentacion mbështetës. Pavarësisht nga kjo, shumica e KZAZ-ve<sup>6</sup> kanë zgjedhur të vijojnë me ngritjen e KQV-ve. Në këndvështrimin e KShH, kjo përbën një praktikë negative të administrimit të zgjedhjeve nga ana e KZAZ-ve, në shkelje të Kodit Zgjedhor, duke i hapur rrugë zëvendësimit të antarëve të KQV prej subjekteve zgjedhore, vetëm pak ditë përpara zgjedhjeve. KShH, duke u mbështetur në rekomandimet e ODIHR-it, ka sugjeruar më parë *ndërtimin dhe konsolidimin e një rrjeti personash të trajnuar mbi ligjin zgjedhor të cilët të jenë të aftë t'i përgjigjen nevojave emergjente, sidomos në prag të datës së zgjedhjeve.*
- Afatet e vendosura në nenin 77 të Kodit Zgjedhor mbi fushatën zgjedhore nuk janë respektuar duke krijuar kështu kushte për garë të pabarabartë midis subjekteve, në favor të atyre që disponojnë mjaftueshëm qëndrueshmëri financiare për të kryer këto aktivitete në një shtrirje më të gjatë kohore, krahasimisht me subjektet zgjedhorë më të vegjël.
- KShH njoftoi KQZ-në menjëherë pas konstatimeve të shkeljes së afatit të shpërndarjes së materialeve nga KZAZ-të pranë KQV-ve sipas Nenit 99 të Kodit Zgjedhor<sup>7</sup>.
- KShH raportoi pranë KQZ-së rastin e intimidimit të qytetarëve të Bashkisë Elbasan të cilëve u është referuar se vota e tyre elektronike do të identifikohet nëpërmjet kryqëzimit të të dhënave midis pajisjeve PEI dhe PEVN. Në vijim të kërkesës së KShH, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, z. Celibashi, deklaroi nëpërmjet një dalje mediatike pacënueshmërinë e procesit.
- Mungesa e hetimeve të shpejta, transparente, të gjithëanshme, si dhe mungesa e ofrimit të një mbrojtje efektive ndaj kallëzuesve të krimeve zgjedhore, janë elementë të përsëritur edhe përgjatë këtyre zgjedhjeve. Hetimet mbi krimin zgjedhor kanë vijuar të shtrihen vetëm në nivele të ulëta të organizimit politik. Të dhënat paraprake mbi hetimin e krimeve zgjedhore evidentojnë një praktikë të dy standartizuar hetimore nga prokuroritë, ndërkohë që informacioni që organet proceduese ndajnë me publikun është minimal.
- Vëzhguesit e KShH konstatuan shkelje në masë të parashikimeve të heshtjes zgjedhore. Në vijim të përcjelljes së këtij informacioni nga KShH, KQZ mori Vendimin nr. 516, datë 13.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëpërmjet të cilit ngarkoi Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake përkatëse me heqjen e materialeve propagandistike nga të gjitha ekranet *led-wall/billboards* në afërsi të KQV-ve, KZAZ-ve dhe VNV-ve. KShH vëren se një vendimmarrje e tillë dhe mobilizimi i institucioneve përkatëse duhet të ishte kryer që në orët e para të mëngjesit të datës 13 Maj 2023.
- Procesi i votimit, i zhvilluar më datë 14 Maj 2023, u monitorua nga vëzhguesit e KShH në 200 Qendra Votimi, të ngritura në 15 prej Bashkive të Republikës së Shqipërisë. Në një pjesë të konsiderueshme të QV-ve të vëzhguara nga KShH, procesi i votimit filloi me vonesë si rrjedhojë e keqfunksionimit të Pajisjeve Elektronike të Identifikimit (PEI) apo mungesës së njohurive dhe koordinimit midis anëtarëve të KQV-ve. Nga 20 Qendrat e Votimit të monitoruara pranë Bashkisë Elbasan dhe Bashkisë Kamëz ku u zbatua procesi i votimit dhe numërimit elektronik, problematika kryesore ishte paqartësia e votuesve për mënyrën e përdorimit të PEVN-së.

<sup>5</sup> Neni 35 pika 2 (13-14 Prill 2023)

<sup>6</sup> Me përjashtimin e KZAZ nr. 24 (Bashkia Durrës) dhe KZAZ-ve të Bashkisë Vlorë

<sup>7</sup> Nga verifikimet në terren të KShH, rezultoi se shpërndarja e materialeve të votimit pranë disa prej KZAZ-ve të monitoruara ishte kryer me vonesa të ndjeshme duke arritur deri në orët e vona të pasdites së datës 12 Maj apo në orët e para të mëngjesit të datës 13 Maj, duke vështirësuar veprimtarinë e KZAZ-ve në ditët më impenjtive të veprimtarisë së tyre.

- Vëzhguesit e KShH konstatuan komunikime të shpeshta të komisionerëve të KQV-ve me vëzhgues të akredituar të subjekteve politike, gjatë së cilave thuhej me zë të lartë numri rendor i zgjedhësit, i cili paraqitej pranë KQV-së për të votuar. Vëzhguesit e subjekteve politike shënonin me kryq apo me grep këto numra në formate tabelare apo në aplikacione të përshtatshme celulare<sup>8</sup>. KShH mendon se KQZ-ja në raste të tilla ka vepruar me vonesë e, si rrjedhojë, parandalimi i kësaj shkeljeje ka qënë i dobët.
- Në kundërshtim të plotë të Nenit 109, pika 6 të Kodit Zgjedhor dhe Urdhërit nr. 62, dt. 03.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vëzhguesit e KShH kanë raportuar prezencë konstante të personave të paautorizuar në zonat rreth Qendrave të Votimit. KShH i përcolli këto evidencime të kryera gjatë monitorimit KQZ-së, duke specifikuar se Komisionerët e QV-ve neglizhojnë ose janë shumë pasivë për të verifikuar ambientet në korridoret dhe oborret e godinave ku janë vendosur personat e paautorizuar.
- U konstatuan raste të votimit familjar që përbëjnë qartazi shkelje të ligjit të toleruar nga KQV. Mosdokumentimi i përshtatshëm i dhënies së ndihmës ndaj zgjedhësve që për shkak të aftësive të veçanta nuk mund të votojnë vetë mbetet problematik dhe në këtë proces votimi. KShH njoftoi menjëherë për rastet e evidentuara KQZ-në.
- Ndërkohë që në tërësi procesi i numërimit të votave u karakterizua nga një klimë e qetë, përpos miratimit të Urdhërit nr. 71, dt. 15.05.2023, të Komisionerit, procesi i numërimit është pezulluar për disa orë pranë 13 prej 20 VNV të monitoruara. KShH gjithashtu vëren me shqetësim mungesën e qasjes së unifikuar sa i takon klasifikimit të saktë të vlefshmërisë së votave. Prezenca e personave të paautorizuar ka vijuar të jetë problematike në VNV, duke qënë se megjithë kontrollin rigoroz të ushtruar nga Policia e Shtetit në hyrje të godinave, një pjesë e konsiderueshme e personave prezentë nuk mbanin të varur në një pozicion të dukshëm akreditimet e tyre, duke krijuar kështu dyshime mbi autorizimin e prezencës së tyre.
- KShH ka parë me rëndësi trajtimin e Vendimit nr. 174, dt. 06.06.2023, të KAS, ku shumica e anëtarëve argumentoi se pretendimeve për pavlefshmërinë e rezultatit të QV-së nr. 2224/01 të ngritur pranë IEVP Rrogozhinë i mungonte bazueshmëria ligjore. KShH vlerëson, duke u bazuar në Vendimin nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese, se votimi i të burgosurve në IEVP është kryer në mënyrë ekstraligjore, duke qënë se votimi i tyre për pushtetin vendor pranë një bashkie pranë të cilës ata nuk banojnë është i padrejtë.
- KShH vlerëson se Vendimi nr. 28 i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor nëpërmjet të cilit u vendos përsëritja e procesit zgjedhor në Bashkinë Rrogozhinë ishte i drejtë. Sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, institucionet e ekzekutimit të vendimit penal janë vendqëndrime e jo vendbanime të burgosurve dhe të burgosurit duhet të votojnë për organet e pushtetit vendor vetëm kur janë banorë të zonës ku vuajnë dënimin. Nga ripërsëritja e zgjedhjeve në Bashkinë Rrogozhinë, institucionet kanë informuar KShH-në se pranë IEVP Rrogozhinë, nga 89 të dënuar të akomoduar me të drejtë vote, vetëm një prej tyre është regjistruar në regjistrat e gjendjes civile të kësaj Bashkie, dhe rrjedhimisht gëzon të drejtën për të votuar specifikisht për këtë Bashki. Rrjedhimisht, pranë IEVP Rrogozhinë, nuk është ngritur një QV në respektim të nenit 62, pika 2 e Kodit Zgjedhor (që kërkon të paktën 15 zgjedhës me të drejtë vote për këtë Bashki).

<sup>8</sup> Evidentuar në Bashkinë Tiranë dhe Elbasan



## **1. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE**

---

Nëpërmjet Vendimit nr. 12/2022<sup>9</sup> datë 10/02/2022, pranë Kuvendit të Shqipërisë u ngrit Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore. Puna e këtij Komisioni u përqëndrua në shqyrtimin e rekomandimeve të përcjella nga OSBE/ODIHR e të paadresuara në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare të datës 25 prill 2021, zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 mars 2022, si dhe proceseve të mëhershme të zgjedhjeve për pushtetin vendor.

KShH vëren me shqetësim praktikën e përsëritur të Komisionit për të realizuar këtë reformë thellësisht të rëndësishme për garantimin e zgjedhjeve sipas standarteve më të mira demokratike, brenda një periudhe të ngushtë kohore. Mbledhja e parë e Komisionit u zhvillua më datë 17 qershor 2022, rreth 11 muaj para datës së dekretuar nga Presidenti për organizimin e zgjedhjeve për pushtetin vendor. Fillimi i vonuar solli shtyrjen e reformës deri në fund të muajit Tetor, më pak se 7 muaj përpara ditës së votimit. Kjo situatë e cila zvogëlon hapësirën për shqyrtim të mirëfilltë të projekt-akteve dhe rekomandimeve objekt diskutimi, cenon parimin e konsultimit gjithëpërfshirës të tërësisë së aktorëve.

Sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR, ndryshimet ligjore në kuadrin, i cili qeveris procesin zgjedhor, nuk duhet të kryhen më vonë se një vit nga nisja e procesit. Procesi zgjedhor nis me dekretimin e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës<sup>10</sup>.

Vlen të theksohet gjithashtu, që Kuvendi vendosi të mos votojë për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Reformës Zgjedhore, veprimtaria e të cilit sipas afateve ligjore të shtyra (çdo gjashtë muaj) i ka shtrirë efektet deri në dt.23 Gusht 2023. Rrjedhimisht, në mungesë të një vendimmarrje për shtyrje të afatit, veprimtaria e këtij Komisioni konsiderohet e përfunduar pa rezultate<sup>11</sup>.

## **2. PUBLIKIMI I LISTAVE DHE NJOFTIMI ME SHKRIM I ZGJEDHËSVE**

---

Në respektim të Nenit 51, pika 4 të Kodit Zgjedhor parashikohet se deri më datën 24 nëntor 2022 duhet të publikohet ekstrakti i parë i listës së zgjedhësve<sup>12</sup>, ndërkohë në pikën 7, dispozita përcakton se *publikimi përsëritet në mënyrë periodike çdo 30 ditë deri në shpalljen e listës së zgjedhësve*. Nga konstatimi i vëzhguesve afatgjatë të KShH-së vërehet se, në përgjithësi, ekstraktet e përbërësve zgjedhorë janë publikuar në respektim të afateve ligjore. Përyjetim evidentohet në Bashkitë Korçë dhe Pogradec të cilat janë konstatuar në shkelje të afatit të ripublikimit të këtyre listave<sup>13</sup>. Përveç ndryshimeve të reflektuara në ekstraktet e afishuara në Bashkinë Gjirokastrë, në asnjë prej Bashkive të tjera të monitoruara nuk janë referuar ndërmarrje procedurash administrative për të ndryshuar përbërës të caktuar të ekstraktit si rrjedhojë e nivelit të ulët të interesit të qytetarëve për t'u njohur me vendndodhjen e QV-ve pranë të cilave do të votonin më 14 Maj 2023.

---

<sup>9</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/02/10/12/efd6bc61-a797-413b-bb7d-54f899840b76;q=vendim%20i%20kuvendit%2012%2F2022>

<sup>10</sup> Dekreti nr. 13864, datë 24.10.2022

<sup>11</sup> <http://gazetashqiptare.al/2023/07/21/nuk-zgjatet-afati-komisionit-te-reformes-zgjedhore-bardhi-ne-shtator-duhet-gjetur-nje-menyre-per-te-ecur-perpara-gjikhuri-skthehemi-ne-piken-0/>

<sup>12</sup> Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile

<sup>13</sup> Si rrjedhojë e hartimit dhe përcjelljes për nënshkrim pranë kryetarit të Bashkisë vetëm një ditë përpara afatit të ripublikimit, përkatësisht më datë 20 shkurt 2023

Një prej formave ndërmjetësuese dhe të rëndësishme për të siguruar arritjen e njohurisë së ekstraktit është pikërisht njoftimi me shkrim i zgjedhësve në banesa, i cili kryhet sipas Nenit 52 të Kodit Zgjedhor. Në vijim të konstatimeve të njëjta gjatë proceseve të mëhershme zgjedhore, KShH ka vënë re me shqetësim se fondi përkatës nga Ministria e Punëve të Brendshme i është alokuar bashkive objekt monitorimi me vonesë. Gjatë anketimeve të kryera në muajin Shkurt<sup>14</sup>, ka rezultuar se në Bashkitë Tiranë, Durrës, Fier dhe Shkodër, procesi po realizohej pa pengesa, por asnjëri prej qytetarëve të anketuar nuk ishte njohur me ekstraktin e përbërësve zgjedhorë. KShH i sugjeroi KQZ-së marrjen e masave konkrete dhe urgjente për të nxitur institucionet përkatëse për të kryer procesin.

Së fundmi, në kundërshtim të pikës 3 të nenit 56 të Kodit Zgjedhor, sipas së cilës, *lista e zgjedhësve i dërgohet, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, KZAZ-së, e cila sipas rastit publikon listën pranë qendrës përkatëse të votimit*, gjatë monitorimeve të kryera në terren, u evidentuan disa Qendra Votimi me lista të paafishuara<sup>15</sup>. Megjithëse listat përfundimtare të zgjedhësve janë publikuar në shumicën prej QV-ve të monitoruara, vëzhguesit e KShH-së raportuan se një pjesë e konsiderueshme prej tyre ishin të pozicionuara në vende të cilat krijojnë pengesa dhe vështirësi në aksesin e zgjedhësve<sup>16</sup> për t'u njohur me përmbajtjen e tyre, si p.sh. për shkak të pozicionimit të kangjellave, lartësisë jo të favorshme të afishimit, kyçjes së derës kryesore të institucionit pas orarit zyrtar, etj. Kjo situatë bie ndesh me pikën 3 të Nenit 56, i cili parashikon që *KZAZ-ja publikon listën pranë qendrës përkatëse të votimit, në një ambient me akses të lirë për zgjedhësit*. Përtej saj, në disa Qendra të tjera Votimit u konstatuan lista të dëmtuara të zgjedhësve, si pasojë e pozicionimit të pafavorshëm përkundrejt prekjes nga kushtet atmosferike, por në raste më sporadike, këto dëme janë shkaktuar nga faktori njerëzor.

### 3. ADMINISTRIMI I PROCESIT ZGJEDHOR

---

#### A. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Përgjatë fazave të procesit zgjedhor, KShH ka monitoruar veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si organi më i lartë administrues i procesit. Ky raport do të ndiqet në vijim nga publikimi i një raporti të thelluar mbi veprimtarinë e KQZ-së përgjatë Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të 14 Majit 2023.

KShH vlerëson përpjekjet më të mira të KQZ për të realizuar një fushatë ndërgjegjësuëse gjithëpërfshirëse, e cila u shtri në një mori platformash (TV, radio, billboards, afishime në linjat urbane, postera, etj.) duke i dhënë tipare të një fushatë miqësore për grupe të ndryshme të synuara. Më tej, KQZ u angazhua në

---

<sup>14</sup> Procesi duhet të kishte përfunduar 60 ditë pas publikimit të ekstraktit të parë (23 Janar 2023)

<sup>15</sup> Bashkia Durrës (QV-1358/00 -1359/01, 1408 – 1409/2); Bashkia Lezhë (QV 0717-0717/2, 0737/1-0738/3, 0733/1, 0705-0706); Bashkia Shkodër (QV 0249 – 0249/0249/1, 0288, 0290, 0236/00 – 0236/01); Bashkia Vlorë (QV 4492-4492/01, 4510-4510/01); Bashkia Gjirokastër (QV 4234, 4238-4239/1, 4254 – 4254/2, 4258-4238/2); Bashkia Elbasan (QV 2356/00 – 2357/00, 2365-2365/1, 2315 – 2317/00, 2350/00 – 2350/01, 2307/00 – 2307/01, 2310/00, 2313/00)

<sup>16</sup> QV 0047/00 - 0048/002, QV 0049/00 - 0049/03 (Bashkia Malësi e Madhe), QV 3885/00 – 3885/03 (Bashkia Pogradec), QV 1683/00 – 1689/02, QV 1740/00 – 1741/02, QV 1934/0 – 1935/0, 1924/00 – 1926/01, QV 2001 – 2002/02, 2013 – 2013/01, QV 2014-2014/2, 2028/1 – 2029/01 (Bashkia Tiranë), QV 4493 – 4495/1, QV 4459 – 4459/2, QV 4507 – 4508/1 (Bashkia Vlorë), QV 0657 – 0657/00, QV 0660 – 0660/00, QV 0653 – 0654 (Bashkia Kukës), QV 3663 - 3665/1, 3670 – 3680, 3668 - 3668/1, 3662 – 3663 (Bashkia Korçë), QV 2390 – 2390/1, QV 2394 - 2395/1, QV 2340, 2345 – 2345/1, QV 2355 – 2355/01, QV 2334-2335/1, 2336 – 2336/00 (Bashkia Elbasan), QV 1176-1176/1 (Bashkia Lezhë)

realizimin e spoteve të ndryshme në gjuhët e minoriteteve dhe në mënyra alternative të përcjelljes së informacionit për njerëzit me aftësi të kufizuara. KQZ gjithashtu u përqëndrua fortësisht tek të rinjtë, votues për herë të parë, si një prej grupeve të synuara nga fushata ndërgjegjësuere. Por pavarësisht nga kjo, në përfundim të fushatës, pjesëmarrja e të rinjve ishte tejet e ulët, duke arritur vetëm 13.5% në përfundim të ditës së votimit<sup>17</sup>.

Sa i përket dokumentit udhëheqës të procesit të edukimit të votuesve, saktësisht *Vendimit Nr. 220, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për “Miratimin e Programit të Edukimit, Informimit dhe Ndërgjegjësimit të Zgjedhësve për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 Maj 2023”* në parim, KShH vijon të vërejë mungesën e treguesve cilësorë dhe sasiorë për të vlerësuar impaktin e fushatës tek publiku i gjerë apo tek grupet e targetuara specifikisht, i cili mbetet një rekomandim i përcjellë nga KShH që prej vitit 2021, kur ky program u prezantua për herë të parë.

Përtej angazhimit të qenësishëm të KQZ, dhe konkretisht Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në edukimin e votuesve, KShH gjithashtu përshëndet bashkëpunimin e ngushtë dhe komunikimin proaktiv të institucionit me organizatat e shoqërisë civile në kuadër të konsultimeve paraprake të projekt vendimeve e urdhërave, pjesëmarrjes në aktivitete, takimeve periodike, koordinimit të qasjes dhe komunikimeve të shpeshhta formale e informale, nëpërmjet të cilave është reflektuar mbi gjetjet e rekomandimet e KShH dhe organizatave të tjera vendase dhe monitoruese.

Megjithëkëtë, KShH i sheh afatet për konsultimin e projekt-akteve të pafavorshme për kryerjen e një rishikimi cilësor të tyre, edhe pse të justifikueshme përballë dinamikës së shpejtë e të pafavorshme në terma kohorë të procesit zgjedhor. KQZ ka lehtësuar qasjen e vëzhguesve në monitorimin e punës së tyre intensive nëpërmjet transmetimit *live* të mbledhjeve të kryera në kanalin *YouTube* të institucionit, duke u bërë një prej institucioneve të para të hapura në këtë nivel ndaj shqyrtimit publik. Gjithsesi, vendimet, urdhërat e udhëzimet e miratuara dhe sidomos procesverbalet shoqëruere të këtyre mbledhjeve, shpesh herë janë publikuar me vonesa të konsiderueshme në faqen zyrtare të *web-it* të KQZ-së, duke shkaktuar pengesa në shqyrtimin e mirëfilltë të tyre dhe reagimin e shpejtë të aktorëve monitorues. KShH vijon të sugjerojë marrjen e masave në vijim nga administrata e KQZ-së, për të arritur publikimin në kohë të këtyre materialeve.

KQZ ka menaxhuar rritjen e sanksioneve administrative të dhëna krahasimisht me Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2021, por gjob at e dhëna mbeten simbolike, çka nuk i ka shërbyer plotësisht parandalimit dhe uljes graduale të shkeljeve të Kodit Zgjedhor nga institucionet dhe subjektet zgjedhore. Janë vërejtur raste kur hetimet administrative për ankesat lidhur me ndalimin e përdorimit të burimeve publike janë zgjatur në kohë. Gjithashtu, ka patur raste kur qëndrimi i KAS ka qënë i kundërt me Komisionerin Shtetëror, duke vendosur në pozita të favorshme subjektet zgjedhore dhe institucionet shtetërore përkatëse që kanë qënë në kushtet e ndalimit, sipas KShH-së (raste të analizuara në vijimësi).

Për të adresuar reflektimin e munguar të institucioneve karshi këtyre sanksioneve, KShH sugjeron ndërmarrjen e një roli proaktiv nga KQZ për të monitoruar zbatimin e vendimmarrjeve të saj. Përtej shkeljeve të përsëritura në raportimin e veprimtarive me karakter publik nga institucionet, vlen të përmendim si rast portretizues të situatës, zbatimin e Vendimit nr. 421, datë 03 Maj 2023. Me anë të tij, Komisioneri vendosi ndalimin e postimeve apo ripostimeve në rrjetet sociale të një institucioni publik të aktiviteteve të cilat pasqyrohen në profilin personal të drejtuesit të institucionit publik, si dhe fshirjen e

<sup>17</sup> <https://www.reporter.al/2023/05/16/votuesit-e-rinj-braktisen-ne-mase-votimet-e-14-majit/>

menjëhershme të çdo postimi me karakter elektoral nga rrjetet sociale të institucioneve publike. Pavarësisht precedentit pozitiv që vendosi ky vendim i KQZ-së për të njohur mediat sociale si pjesë të rrjeteve të komunikimit të cilat përdoren në kuadër të fushatës zgjedhore, impakti i tij rezultoi i munguar në praktikë pasi KShH vërejti se rrjetet sociale të institucioneve publike ende gjendeshin të tejmbushura me imazhe propaganduese të fushatës.

Ndër momentet kur KShH vlerëson se fryma e interpretimit të KAS synonte mundësimin pozitiv të një gare sa më të hapur midis subjekteve zgjedhore ishte rasti gjerësisht i diskutuar i regjistrimit të Partisë Demokratike<sup>18</sup>.

## **B. NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR (KZAZ)**

Në respektim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor në nenin 28 të tij, si dhe Vendimit Nr. 49, datë 10.02.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin përcaktohet data për zhvillimin e mbledhjes së parë të KZAZ-ve, shumica e KZAZ-ve të ngritura pranë Bashkive objekt monitorimi kanë zhvilluar mbledhjen e parë brenda datave 13-14 shkurt 2023<sup>19</sup>. Ndërkohë, në shkelje të plotë të këtyre parashikimeve ligjore, KZAZ nr. 32, 36 dhe 40 pranë Bashkisë Tiranë konstatohet të jenë ngritur më datë 17 Shkurt, 28 Shkurt dhe 1 Mars 2023, me një vonesë që varion nga 3 deri në rreth 10-15 ditë. Shkak për këtë vonesë referohet mungesa e plotësisht me anëtarë si rrjedhojë e vonesave të regjistrimit të subjektit zgjedhor Partia Demokratike.

Në studim të praktikës dokumentare ka rezultuar se KZAZ nr. 40 pranë Bashkisë Tiranë ka ndjekur një praktikë pozitive pune sa i përket mbledhjeve të realizuara në baza ditore për të diskutuar mbi çështje të ndryshme dhe për të adresuar problemet e shfaqura në kohë reale. KShH rekomandon që praktikën e mira të ndahen e njihen nga KZAZ-të e tjera, në zgjedhjet e ardhshme, si një hap i rëndësishëm për të përcjellë e zgjidhur në kohë çështjet që janë objekt diskutimi dhe vendimmarrjeje i këtyre organeve.

Kodi Zgjedhor, në nenin 32, në gjermën “ç” të tij, ka parashikuar si një ndër shkaqet kur *anëtarët/sekretari i KZAZ-së shkarkohen nga detyra, edhe mosmarrjen pjesë në trajnime ose kur nuk kalojnë testet e organizuara nga KQZ*. Gjatë intervistimeve të realizuara me anëtarët e KZAZ-ve të monitoruara, të cilët janë emëruar që prej ngritjes së KZAZ-ve, referohet pjesëmarrja e tyre pro-aktive në këto trajnime. Si rrjedhojë e emërimit të mëvonshëm të anëtarëve të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike, trajnimi i tyre u realizua vetëm gjatë javës së parafundit të muajit prill, në afate tejet të pafavorshme duke marrë në konsideratë se për më pak se tri javë, faza parazgjedhore e procesit do të përfundonte.

Sipas nenit 99 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve, materialet përkatëse zgjedhore për administrimin e procesit të votimit, të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi. Nga verifikimet në terren të KShH rezultoi se shpërndarja e materialeve

---

<sup>18</sup> Më datë 9 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zhvilloi seancën për regjistrimin e 6 prej partive kërkuese. KShH vlerëson së qëndrimi i Komisionerit për të kërkuar plotësime minimale, të firmosura nga z. Basha, në kërkesën për regjistrim të partisë “Partia Demokratike” të kryesuar nga kryetari i komanduar z. Alibeaj ishte i gabuar dhe qëndrimi i KAS nëpërmjet Vendimit nr. 27, datë 16.03.2023, “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 32, datë 14.03.2023 dhe nr. 33, datë 15.03.2023” vendosi detyrimin e partisë “Partia Demokratike”, kryesuar me komandim nga z. Alibeaj, për të depozituar dokumentacionin e kërkuar me të dhënat e tij si nënkryetar në cilësinë e kryetarit të komanduar.

<sup>19</sup> KZAZ nr. 01 (Malësi e Madhe); 02, 03, 04 dhe 05 (Shkodër); 11(Kukës); 19 (Dibër); 21, 22 (Durrës); 35, 37, 41 (Tiranë) 57, 58 dhe 59 (Fier); 65 dhe 66 (Berat); 69 (Pogradec); 73 dhe 74 (Korçë); 80 (Gjirokastrë); 83, 84, 85 dhe 86 (Vlorë).

të votimit pranë disa prej KZAZ-ve të monitoruara<sup>20</sup> ishte kryer me vonesa të ndjeshme duke arritur deri në orët e para të mëngjesit të datës 13 Maj. Si rrjedhojë, KShH vuri re se anëtarët e KZAZ-ve ishin të tensionuar dhe po punonin në kushtet e mbingarkesës për arritjen e afateve që parashikon Kodi Zgjedhor. Tërësia e problematikave të konstatuara gjatë këtij procesi ju përcollën KQZ-së me synim reagimin e shpejtë dhe zhbllokimin e procesit, por të dhënat e mëtejshme të monitorimit treguan se afatet nuk arritën të respektoheshin, duke qënë se në disa KZAZ procesi i dorëzimit të materialeve përfundoi përpara mesnatës së datës 13 maj apo në orët e para të mëngjesit të ditës së votimit, përkatësisht të datës 14 Maj<sup>21</sup>.

### C. NGRITJA E KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT

Subjektet zgjedhore, të cilat mund të propozojnë komisionerë përcollën listat vetëm në ezaurim të afatit të vendosur nga pika 2 e nenit 36 të Kodit Zgjedhor<sup>22</sup>, ndërkohë disa komisionerë të KZAZ-ve të monitoruara<sup>23</sup> referuan se edhe pse listat e propozimeve të subjekteve zgjedhore janë përcjellë në afat, ato kanë qënë të paplotësuara prej tyre me dokumentacion mbështetës apo të vjetëruara<sup>24</sup>. Me përjashtimin e komisionerëve të KZAZ nr. 24 të Bashkisë Durrës dhe KZAZ-ve të Bashkisë Vlorë, të gjithë KZAZ-të e tjera kanë zgjedhur të operojnë duke ngritur KQV-të e zonës, me arsyetimin se listat e përcjella në këtë moment janë paraprake dhe dokumentacioni përkatës merret vetëm 10-15 ditë përpara zgjedhjeve. Në vlerësimin e KShH, kjo përbën një praktikë negative të administrimit të zgjedhjeve nga KZAZ-të, në shkelje të Kodit Zgjedhor. Kjo praktikë i hapi rrugë zëvendësimit të antarëve të KQV-ve, prej subjekteve zgjedhore, vetëm pak ditë apo pak orë përpara nisjes së procesit të votimit, një procedurë e ndjekur qartazi ndër vite nga subjektet zgjedhore, e cila dëmton mire administrimin e procesit.

Si rrjedhojë e shkrirjes së Zyrrave Rajonale Zgjedhore bazuar në Udhëzimin nr.4 të Komisionit Rregullator më datë 02.02.2023<sup>25</sup>, duke u bazuar në monitorimet e proceseve zgjedhore të mëparshme, KShH vlerëson se ky rregullim duhej shoqëruar me praktikën pozitive të *ndërtimit dhe konsolidimit të një rrjeti personash të trajnuar mbi ligjin zgjedhor, të cilët të jenë të aftë t'i përgjigjen nevojave emergjente të organeve të administrimit zgjedhor në nivel të dytë e të tretë (KZAZ dhe KQV), sidomos në prag të datës së zgjedhjeve. Ky qëndrim bazohet në rekomandimet e mëhershme të KShH dhe OSBE/ODIHR-it. Prezenca e këtij rrjeti, shoqëruar me ndalimin kategorik nëpërmejt dispozitave të përshtatshme ligjore të fenomenit të zëvendësimeve urgjente në këto organe, do të shërbente ndaj përmirësimit të situatës.*

Si rrjedhojë e përcjelljes së listave dhe dokumentacionit mbështetës në limit të afatit kohor, disa prej KZAZ-ve objekt monitorimi, në këndvështrimin e KShH, e kanë patur të pamundur të kryejnë verifikim përmbajtësor të plotë e të saktë të këtyre listave dhe plotësimit të kriterëve prej antarëve të propozuar për KQV-të. Në këtë kuptim, pranë KZAZ nr. 01, Bashkia Malësi e Madhe gjatë verifikimit janë konstatuar

<sup>20</sup> KZAZ-të nr. 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40 (Bashkia Tiranë) dhe KZAZ nr. 23 (Bashkia Durrës)

<sup>21</sup> KZAZ 1, KZAZ 80

<sup>22</sup> Jo më vonë se 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve

<sup>23</sup> KZAZ-të nr. 02, 03, 04 dhe 05 (Bashkia Shkodër); 24 (Bashkia Durrës), 47, 48, 49 dhe 50 (Bashkia Elbasan); 69 (Bashkia Pogradec); 83, 84, 85, dhe 86 (Bashkia Vlorë)

<sup>24</sup> Të njëjtat lista me ato të përcjella për zhvillimin e Zgjedhjeve për Kuvend 2021. Në KZAZ-në nr. 50 pranë Bashkisë Elbasan, ky fenomen ka ardhur në dijeni të antarëve të KZAZ sepse njëri prej tyre ka evidentuar emrin e tij në njërin prej listave. Lista është dërguar sërish pas për t'u plotësuar saktë.

<sup>25</sup> [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-nr.-4-date-2.2.2023- amendim udhezimi-2\\_KRR.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-nr.-4-date-2.2.2023- amendim udhezimi-2_KRR.pdf)

anëtarë të emëruar, të cilët kanë përfunduar vetëm arsimin bazë 9-vjeçar, në shkelje të plotë të Nenit 38 pika 1/b<sup>26</sup>.

Së fundmi, nga monitorimet nga afër të trajnimeve të anëtarëve të KQV-ve pranë disa KZAZ-ve, KShH konstatoi prezencë të paktë të komisionerëve të KQV-ve të emëruar. KShH sugjeron zbatimin e masave përkatëse për anëtarët të cilët nuk ndjekin trajnimet, duke i hequr automatikisht antarësinë në KQV dhe duke i zëvendësuar më individë që i përkasin trupës së profesionistëve të cilët mund të emërohen kryesisht nga KQZ.

#### **D. NGRITJA E GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE (GNV)**

Kodi Zgjedhor parashikon në nenin 95 pika 1 të tij se *për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para datës së votimit, caktohen Grupe të Numërimit të Votave dhe propozimet për emërimin e anëtarëve duhet të dorëzohen në KZAZ të paktën 12 ditë para datës së zgjedhjeve*. GNV u ngritën brenda afatit<sup>27</sup> në shumicën prej KZAZ-ve të monitoruara. Ndërkohë, KZAZ-ja nr. 12 pranë Bashkisë Lezhë i ka ngritur GNV-të me një ditë vonesë; KZAZ-të nr. 21, 22, 23, 24 (Bashkia Durrës), 83, 84, 85 dhe 86 (Bashkia Vlorë) pezulluan procesin deri më datat 11-12 Maj si rrjedhojë e dokumentacionit mbështetës të paplotë të përcjellë nga subjektet zgjedhore propozuese; dhe KZAZ-të nr. 31, 32, 33 dhe 41 të ngritura pranë Bashkisë Tiranë janë ngritur 4 deri në 5 ditë me vonesë.

Ndërkohë, subjektet zgjedhore propozuese, në shumicën e rasteve, i kanë përcjellë propozimet brenda afatit të sipërcituar, me përjashtimin e rasteve të përcjelljes së propozimeve pranë KZAZ-ve të juridiksionit të Bashkisë Durrës dhe Vlorë, të cilët vonuan përcjelljen me 5 ditë. Listat me propozime për antarësinë janë përcjellë të plota, përveç GNV-ve të ngritura pranë KZAZ-së nr. 3 në Bashkinë Shkodër, ku mungonin në tërësi anëtarët e Partisë Demokratike.

Si rrjedhojë e vonesave që karakterizuan procesin në disa prej Bashkive të vendit të shkaktuara nga zëvendësimi i anëtarëve të propozuar prej subjekteve zgjedhore, kryerja e trajnimeve për anëtarët e GNV-ve u arrit, në shumicën prej tyre, vetëm në orët përpara fillimit të procesit të numërimit, duke krijuar kështu boshllëqe në njohuritë e këtyre anëtarëve mbi këtë proces me rëndësi të lartë.

## **4. FUSHATA ZGJEDHORE**

---

### **A. SHTRIRJA E FUSHATËS SË PARAKOHSHME**

Përgjatë periudhës parazgjedhore, KShH evidentoi një sërë shkeljesh kryesisht nga subjektet zgjedhore më të mëdha, në cenim të nenit 77 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit *fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve*. Në këtë kuptim, çdo aktivitet që i përket natyrës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2023 duhet të fillonte prej datës 14 Prill 2023 e të vijonte deri në hyrjen në fuqi të periudhës së heshtjes zgjedhore. Mosrespektimi i afateve të fillimit të fushatës zgjedhore krijoi kushte për garë të pabarabartë midis

---

<sup>26</sup>Anëtar ose sekretar të KQV-së mund të emërohen personat që kanë të paktën arsimin e mesëm

<sup>27</sup> 04 Maj 2023

subjekteve, duke favorizuar ato që kishin burime të qëndrueshme financiare, krahasimisht me subjektet e tjera.

Aktivitetet e fushatës parazgjedhore<sup>28</sup> kanë filluar në mënyrë të dukshme gjatë muajit Dhjetor 2022, por subjektet më të mëdha zgjedhore, fill pas zyrtarizimit të kandidaturave të tyre kanë shtuar përpjekjet për të arritur qytetarët nëpërmjet takimeve publike, kremtimeve, shpërndarjeve të pamfletve, etj. Në Bashkinë Tiranë, kandidatët e subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe koalicionit “Bashkë Fitojmë” filluan fushatat përkatëse në fillim të vitit 2023<sup>29</sup>. Një situatë e ngjashme, është vënë re në Bashkitë Pogradec, Gjirokastrë, Kukës dhe Malësi e Madhe<sup>30</sup>.

## **B. KLIMA E FUSHATËS ZYRTARE**

Në këndvështrimin e KShH-së, fushata zgjedhore zyrtare prej një muaji përgjithësisht u karakterizua nga nota të qeta. Megjithatë u shënuan disa akte sporadike kriminale dhe vandalizmi. KShH reagoi publikisht duke dënuar ashpër aktin kriminal me rrezikshmëri të theksuar shoqërore kryer ndaj kreut të PD-së në Vaun e Dejës, Z. Bernard Ndreca, pranë derës së shtëpisë së të cilit shpërtheu sasia e eksplozivit e vendosur poshtë makinës. KShH bëri thirrje për hetimin me objektivitet, duke respektuar parimin e pavarësisë. Në vijim, vlen për t’u përmendur se zbardhja e këtij akti kriminal dhe akteve të tjera të ngjashme shërbejnë për të rritur besimin e elektoratit në zbatimin e proceseve zgjedhore të painfluencuara nga palë të treta, si për shembull, në këtë rast, nga segmente kriminale, të organizuara apo jo.

Kryesisht, fushata u drejtua nga liderët e subjekteve zgjedhore dhe partive kandiduese e jo nga kandidatët për pushtetin lokal, duke dëshmuar kështu më tej qëndërzimin e pushtetit politik. Duke qënë se partitë politike përfaqësojnë fraksione të ndryshme të mendimit politik të popullatës, KShH vijon të bëjë thirrje për decentralizimin dhe demokratizimin e brendshëm të tyre në përputhje me përpjekjet për demokratizim të mëtejshëm të vendit. Përgjatë tërësisë së fushatës, pjesës më të madhe të subjekteve zgjedhore i mungoi shpalosja e platformave politike, prezantimi i të cilave do t’i mundësonte elektoratit njohjen me objektivat dhe nismat konkrete të kandidatëve për qeverisjen vendore dhe marrjen e vendimeve të mirëmenduara.

Si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e qëndërzimit të fushatës tek liderët politikë, një pjesë e konsiderueshme e premtimeve të bëra, sidomos nga subjekti zgjedhor që ka mazhorancën qeverisëse, buronin drejtpërdrejt nga vendime të pushtetit qendror, jashtë tagrit të vendimmarrjes lokale.

---

<sup>28</sup> Termi jozyrtar i cili përdoret për të përshkruar tërësinë e aktiviteteve të cilat ndërmerren nga partitë politike/subjektet zgjedhore në periudhën kohore përpara fushatës zgjedhore sipas Nenit 77 të Kodit Zgjedhor.

<sup>29</sup> Konkretisht, z. Belind Këlliçi, kandidat i subjektit BF, ka ushtruar aktivitetin nëpërmjet lëvizjes së makinave të loguara me parullën e fushatës dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve përgjatë trotuareve me trafik të lartë këmbësor. Ndërkohë dhe z. Veliaj, kandidat i rikandiduar i subjektit PS në këtë Bashki, ka kryer një sërë takimesh me banorë të kryeqytetit. Të dy kandidatët kanë ushtruar mundësinë për të shpalosur pjesë të platformave të tyre në programe televizive *prime time*.

<sup>30</sup> Në Bashkinë Pogradec, kandidati i subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, z. Tollozhina, gjatë fillimit të muajit Prill ka postuar foto të rrugëve të amortizuara të qytetit, shoqëruar me sloganin e fushatës dhe premtime elektorale. Ndërkohë, kandidatët e rikandiduar të subjektit PS në Bashkinë Gjirokastrë dhe Malësi e Madhe kanë ndërmarrë një zinxhir takimesh në zona të ndryshme të juridiksionit territorial të këtyre Bashkive. Duke filluar nga mesi i muajit Mars 2023, të dy kandidatët përfaqes të subjekteve PS dhe koalicioni Bashkë Fitojmë, respektivisht, Z. Safet Gjici dhe Z. Admir Sinamati, kanë iniciuar takimet elektorale me banorë të zonave rurale të Kukësit (kryesisht në kafene të lagjeve apo në oborret e shkollave 9-vjeçare, duke krijuar kështu dhe terren për shpërdorim të burimeve shtetërore). Ndërkohë, z. Gjici është angazhuar gjithashtu në një takim me qytetarë të Bashkisë Kukës në Birmingham, Londër, kryeqytet i Mbretërisë së Bashkuar.

Një pjesë e madhe e premtimeve të tërësisë së subjekteve zgjedhore vlerësohen si të tepruara e të paarrtshme në mënyrë objektive, duke ndikuar kështu në krijimin apo përfundimin e pakënaqësisë publike dhe dobësimin e besimit të tyre tek partitë politike dhe zgjedhjet në tërësi. Nga sondazhet e kryera në terren prej vëzhguesve të KShH, u vunë re nota të larta apatie, zhgënjimi dhe tendenca për të mos votuar, duke rrezikuar kështu demokratizimin e mëtejshëm të vendit. Qytetarët e pyetur pranë Bashkisë Korçë, Durrës dhe Kukës kanë referuar se situata e vështirë ekonomiko-financiare i bën mosbesues ndaj procesit zgjedhor dhe ndryshimeve që priten prej tij. Njëkohësisht, një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve në bashkitë subjekt monitorimi kanë pohuar se kanë konstatuar angazhim të administratës shtetërore në ndihmë të aktiviteteve të fushatës.

Rasti më shqetësues për të cilin KShH u vu në dijeni nëpërmjet kontakteve me qytetarët ishte sinjalizimi se intimidoheshin nga eksponentë të subjektit PS, të cilët u referonin informacion se vota e tyre elektronike do të jetë tërësisht e identifikueshme nëpërmjet kryqëzimit të të dhënave midis pajisjes PEI<sup>31</sup> dhe pajisjes PEVN<sup>32</sup>. Në vijim të këtij presioni, ata referuan se ju kërkohej të votojnë për kryetarin aktual të Bashkisë, njëkohësisht kandidat i subjektit zgjedhor PS. KShH vuri në dijeni KQZ-në duke kërkuar dhënien e garancisë për votimin elektronik ndaj qytetarëve, me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, ndaj pamundësisë së këtij veprimi. Në vijim të kësaj shkrese, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, z. Celibashi, deklaroi publikisht pacënueshmërinë e procesit, duke qënë se kryqëzimi i të dhënave të dy pajisjeve është i pamundur.

### C. MBULIMI MEDIATIK

Mbulimi mediatic i fushatës gjithashtu u përqëndrua tek liderët politikë dhe gara për Bashkinë e Kryeqytetit, lehtësisht e evidentueshme nga emisionet *prime time*. Kandidatët për Bashkinë Tiranë patën mundësinë për të prezantuar premtimet e tyre në këto emisione të televizioneve kombëtare, ndërkohë që e njëjta mundësi ju ofrua një pjese shumë të vogël të kandidatëve për kryetar bashkie në bashkitë e tjera përtej Tiranës. Duke patur parasysh statusin kombëtar të këtyre televizioneve, KShH vlerëson se më tepër masa duhet të ishin marrë prej tyre për të përfshirë pjesën më të madhe të kandidatëve në emisione të tjera, përtej edicionit informativ.

Televizionet, sipas parashikimit të Nenit 80 pika 1 mbi radiotelevizionin publik dhe Nenit 84 për radiot dhe televizionet private, të Kodit Zgjedhor, i kanë kushtuar një fraksion kohor minimal subjekteve zgjedhore të cilat janë parti joparlamentare apo kandidatë të propozuar nga zgjedhësit. Këto dispozita i vendosin subjektet e lartpërmendura në pozitë jo të favorshme, duke krijuar barriera ndaj pluralizimit të mendimit dhe përfaqësimit politik. Ndërkohë, Neni 78 pika 3 i Kodit Zgjedhor i cili parashikon se *rregullat, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në këtë ligj kanë qëllim garantimin e barazisë së subjekteve zgjedhore* qëndron në raport tërësisht të zhdrejtë me situatën faktike të krijuar.

Kryesisht në edicionet informative, KShH vijon të konstatojë me shqetësim se materialet audio-vizuale të regjistruara nga partitë politike apo kandidatët përbëjnë pjesën dërrmuese të materialeve të shfaqura në televizion, në përputhje me Nenin 84/1 të Kodit Zgjedhor, i cili legjitimon transmetimin e tyre. Këto materiale variojnë nga filmimet e para regjistruara të takimeve, *podcasts*, dhe forma të tjera të transmetimit digjital. Kështu, subjektet lejohen të prezantojnë aspektet më tërheqëse të fushatës së tyre, duke u

<sup>31</sup> Pajisja Elektronike e Identifikimit

<sup>32</sup> Pajisja Elektronike e Votimit dhe Numërimit



avantazhuar përballë perceptimit publik. Një rekomandim i njëjtë për moslejimin e materialeve të regjistruara më parë përcillet nga OSBE/ODIHR në raportet e tyre prej vitit 2009 e në vazhdim. Pavarësisht reagimeve dhe rekomandimeve të përcjella nga OSBE/ODIHR dhe KShH ndër vite, reforma zgjedhore ende nuk e ka adresuar dhe zgjidhur këtë çështje. Edhe gjatë këtij viti elektoral munguan tërësisht përballjet direkte apo debatet midis kandidatëve.

#### **D. PËRDORIMI I BURIMEVE SHETËRORE**

Në kuadër të monitorimeve dhe sinjalizimeve të mbërritura, KShH ka përcjellë pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve katër raste të përdorimit të burimeve shtetërore. Në njërin prej rasteve, u vu re se më datë 1 Prill 2023, kandidati i rikandiduar për Kryetar Bashkie, z. Sotiraq Filo, ka realizuar aktivitetin me temë “Takim me Asamblenë e zgjeruar të PS të Korçës”. Më herët, ky aktivitet është konsideruar veprimtari e ndaluar<sup>33</sup>. Gjithsesi, ky aktivitet është zhvilluar dhe Komisioneri, pas sinjalizimit të KShH, ka referuar çështjen pranë KAS<sup>34</sup>, i cili nëpërmjet Vendimit nr. 73, dt. 02.05.2023, interpretoi se ky aktivitet është qartësisht i një natyre politike e jo institucionale, dhe si i tillë, ndalimi i këtij aktiviteti nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe kërkesa e tij për vendosjen e sanksioneve administrative konsiderohen si të pambështetura në ligj dhe në prova. Pavarësisht kësaj, KShH mendon se interpretimi i mësipërm nuk është i drejtë dhe i bazuar, ndaj vendimmarrja e KAS nuk i shërbeu pozitivisht ndalimit të përdorimit të burimeve shtetërore për qëllime elektorale.

Sërisht nga Bashkia Korçë u raportua një rast, sipas të cilit Zyra Vendore Arsimore e Qarkut Korçë kërkonte raportim tabelar në lidhje me veprimtaritë e adresave zyrtare në rrjete sociale të institucioneve arsimore, ku një prej kolonave pëkatëse i dedikohet numrit të ripostimeve të postimeve të bëra nga Ministri i Arsimit dhe Sporteve. Nga verifikimet e mëtejshme të kryera nga KShH, u konstatua se ripostime të njëjta po kryheshin nga faqet zyrtare të rrjeteve sociale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë, Maminas, Dibër, Kamëz, etj. Në vijim të këtij sinjalizimi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë Vendimin nr. 421, dt. 03.05.2023<sup>35</sup>, nëpërmjet të cilit ndalon postimet apo ripostimet në rrjetet sociale të institucioneve publike të aktiviteteve, të cilat pasqyrohen në profilin personal të drejtuesve të institucioneve publike. Përtej impaktit të drejtpërdrejtë të këtij vendimi në përpjekjet për ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore, ai konsiston gjithashtu në njohjen për herë të parë nga KQZ-ja të mediave sociale si një burim transferimi informacioni, sidomos në kuadër të fushatës, rekomandim të cilin KShH e ka përcjellë dhe më herët ndaj KQZ-së<sup>36</sup>. Edhe pse impakti i këtij vendimi në aspektin normativ (rregullator) është i lartë, nga vëzhgimet vijuese të KShH në rrjetet sociale u vunë re ripostime të aktiviteteve me karakter fushate në shkelje të tërësishme të vendimit të sapomarrë nga KQZ.

Pranë, KShH është sinjalizuar rasti nga Bashkia Vlorë, sipas të cilit, më datë 3 Mars 2023 u zhvillua aktiviteti me temë “Gruaja në sipërmarrje, rruga drejt fuqizimit të sipërmarrjes dhe roli i grave në këtë proces” nga Partia Socialiste Dega Vlorë. Duke qënë se aktiviteti është zhvilluar në orën 12.00 të kësaj dite dhe pjesëmarrës në të ishin punonjës të institucioneve vendore në varësi të Bashkisë Vlorë, zbatimi i këtij aktiviteti përbën shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Pas marrjes në shqyrtim të këtij denoncimi

<sup>33</sup> <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/Vendim-nr.-231-date-31.3.2023-Per-ndalimin-e-veprimtarise-publike-te-Bashkise-Korce.pdf>

<sup>34</sup> <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-412-date-25.04.2023-Per-sanksion-bashkia-Korce.pdf>

<sup>35</sup> [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Vendim\\_nr.421\\_date-01.05.2023-Vendim-per-Ministrine-e-Arsimit-dhe-Sportit-dhe-ZVA-Korce.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Vendim_nr.421_date-01.05.2023-Vendim-per-Ministrine-e-Arsimit-dhe-Sportit-dhe-ZVA-Korce.pdf)

<sup>36</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/03/24032021\\_Rev\\_Raport-Monitorimi-KQZ-Shkurt-2021-2.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/03/24032021_Rev_Raport-Monitorimi-KQZ-Shkurt-2021-2.pdf)

nga KQZ, Komisioneri<sup>37</sup> ka argumentuar se, së pari, për ta konsideruar këtë veprimtari shkelje, duhet të plotësohet kushti i qëllimit zgjedhor për mbajtjen e aktivitetit, element i cili nuk i përket kompetencës lëndore të KQZ e, kësaj, nuk mund të vlerësohet prej tyre. Së dyti, duke qënë se subjekti mbajtës i aktivitetit, Partia Socialiste, është regjistruar si subjekt zgjedhor 6 ditë pas mbajtjes së aktivitetit<sup>38</sup>, aktiviteti nuk mund të konsiderohet të jetë kryer në shkelje duke qënë se të drejtat e detyrimet lindin pas regjistrimit. KShH vlerëson se interpretimi i KQZ-së nuk është i drejtë, pasi në përmbajtje të nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor përmendet ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje edhe të partive politike (jo vetëm të subjekteve zgjedhore). Ndërkohë që formulimi i nenit 91 gjithashtu është i diskutueshëm pasi lehtëson pozitat e partive politike që fillojnë më herët fushatën zgjedhore. Kjo për arsye se përmbajtja e kësaj dispozite (pika 2 dhe 3 e nenit 91) sanksionon ndalimin e përdorimit të burimeve publike gjatë fushatës zgjedhore (e cila edhe pse ligjërisht fillon një muaj para zgjedhjeve, *de facto* fillon më herët).

Ndërkohë, gjatë javës së fundit të fushatës zgjedhore, subjekti zgjedhor “Partia Socialiste” u angazhua në një seri tubimesh përmbyllëse të fushatës, një prej të cilëve u zhvillua pranë Bashkisë Lezhë më datë 07 Maj 2023, ku KShH u sinjalizua se pajisjet elektrike dhe elektronike të përdorura për të mundësuar zhvillimin e këtij aktiviteti, ishin të lidhura me një makinë, mbajtëse të generatorit, e cila mbante logon e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (*OSHEE*)<sup>39</sup> në xhamin e parmë.

Vetëm një ditë përpara Ditës së Votimit, KShH denoncoi rastin e sinjalizuar nga juridiksioni i Bashkisë Tiranë, sipas së cilës pas mbylles së fushatës zgjedhore në Tiranë, Kryeministri dhe Kryetari i Bashkisë i rikandiduar në Tiranë bënë një vizitë pranë Piramidës<sup>40</sup>. KShH, nëpërmjet përcjelljes shkresore të këtij denoncimi pranë KQZ-së, si dhe në denoncimet paraardhëse, i ka bërë thirrje këtij të fundit që të marrë masat për të realizuar një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm mbi rastin.

Në përfundim të afatit të caktuar për hetimin administrativ sipas Vendimit nr. 9, 09.03.2021, të Komisionit Rregullator<sup>41</sup>, i cili në Nenin 7, pika 2, përcakton se *afati për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 ditë*, Komisioneri nëpërmjet Vendimit nr. 706, dt. 17.07.2023 të tij<sup>42</sup> shtyu afatin për kryerjen e procedurave të hetimit administrativ për këtë denoncim. Ndërkohë, KShH nuk ka informacion konkret mbi fazën hetimore në të cilën gjendet çështja e përdorimit të makinës së OSHEE në kuadër të mbylljes së fushatës në Bashkinë Lezhë.

<sup>37</sup> <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-432-date-02.05.2023-Helsink-Vlore-338.pdf>

<sup>38</sup> Subjekti Partia Socialiste është regjistruar si subjekt zgjedhor me Vendimin nr. 153, datë 09.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Politike Partia Socialiste e Shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 Maj 2023” <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/Vendim-Nr.153-date-09.03.23-Regj-PS.pdf>

<sup>39</sup> Një pjesë e aksioneve të së cilit janë pronë e shteti shqiptar, përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë

<sup>40</sup> Në këndvështrimin e KShH, kjo veprimtari për aq sa pasqyrohet në media <https://ata.gov.al/2023/05/11/hapet-piramida-e-tiranes-veliaj-qendra-me-e-madhe-digjitale-ne-ballkan/?amp=1> rezultoi të jetë e ndaluar në raport me rastet e konkretizuara në Vendimin nr. 9, dt. 24.12. 2020 të Komisionit Rregullator, sipas Nenit 3, pika 1.1., germa “c”. KShH, nëpërmjet përcjelljes shkresore të këtij denoncimi pranë KQZ-së, si dhe në denoncimet paraardhëse, i ka bërë thirrje këtij të fundit që të marrë masat për të realizuar një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm mbi rastin.

<sup>41</sup> [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/Vendime-Regullatori/2021/03/Vendim\\_Nr.009\\_210309- Procedurat-e-funksionimit-dhe-mirembajtjes-se-portalit-procedurat-dhe-afatet-e-hetimit-administrativ-te-denoncimeve-dhe-vendimin..pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/Vendime-Regullatori/2021/03/Vendim_Nr.009_210309- Procedurat-e-funksionimit-dhe-mirembajtjes-se-portalit-procedurat-dhe-afatet-e-hetimit-administrativ-te-denoncimeve-dhe-vendimin..pdf)

<sup>42</sup> [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/Vendim\\_nr\\_706\\_-date-17.07.2023\\_Zgjatje-afati-mbi-denoncimin-nr-444-dhe-449-ID-1.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/Vendim_nr_706_-date-17.07.2023_Zgjatje-afati-mbi-denoncimin-nr-444-dhe-449-ID-1.pdf)

## **E. KRIMET ZGJEDHORE**

Mungesa e hetimeve të shpejta, transparente, të gjithëanshme, si dhe mungesa e ofrimit të një mbrojtje efektive ndaj kallëzuesve të krimeve zgjedhore, janë elementë të përsëritur edhe përgjatë këtyre zgjedhjeve. Hetimet mbi krimin zgjedhor kanë vijuar të shtrihen vetëm në nivele të ulëta të organizimit politik. Angazhimi solemn i Kryetarëve të partive, sipas nenit 64 të Kodit Zgjedhor, mbetet formal dhe shitblerja e votave mbetet një fenomen shqetësues që cenon integritetin dhe ndershmërinë e zgjedhjeve në vendin tonë.

Pak ditë para ditës së votimit të zgjedhjeve vendore të dt.14 Maj, u vërejt një fluks i shtuar i rasteve të dyshuara si shitblerje e votave në disa Bashki të vendit<sup>43</sup>, të sinjalizuara kryesisht në media. Në konferencën për mediat të datës 12.05.2023 të Policisë së Shtetit, u bë e ditur për publikun se gjatë periudhës 14.04.2023 deri më 12.05.2023, janë evidentuar gjithsej 54 raste të veprave penale në fushën e krimeve zgjedhore, për të cilat janë proceduar penalisht gjithsej 88 shtetas. Ndarja e të dhënave të tilla nga Policia e Shtetit, në pjesën fundore të periudhës kur referohet se janë bërë kallëzimet është e vonuar. Rrjedhimisht, ky informacion nuk i shërben qasjes sistematike të transparencës dhe as nxitjes së denoncimeve që ndihmojnë për të çrrënjësuar kulturën e pandëshkueshmërisë së këtyre veprave penale

Përfundimi i veprimeve procedurale, për një rast të sinjalizuar në Prokurorinë e Dibrës, në një kohë të shpejtë dhe nxjerrja e përfundimeve, mbi një kallëzim sensitiv<sup>44</sup>, krijoi një praktikë të dy standartizuar në raport me rastet e sinjalizuara apo denoncuara publikisht në media, në disa Bashki të tjera, sikurse është rasti i Bashkisë Himarë. Informacioni që organet proceduese ndajnë me publikun është minimal dhe vërehet një qasje jo e unifikuar nga prokuroritë kompetente në këtë drejtim. Të dhënat për këto vepra penale vijnë të jenë ende në proces përpunimi sasior dhe cilësor, por në tërësi KShH vlerëson se hetimi i krimit zgjedhor nga organet proceduese është shumë i vonuar në kohë. Gjithashtu, mungojnë kryesisht rastet e ndjekura me iniciativën e prokurorisë, ndërkohë që sikurse dihet, organizimi i subjekteve zgjedhore për procesin parazgjedhor nis shumë muaj më parë.

## **5. DEKRIMINALIZIMI**

---

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të përditësuar në vitin 2016<sup>45</sup>, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Vendimin nr. 17/2016 ku përcaktohen rregulla të detajuara, mbi procedurën që do të ndiqet nga Prokuroria e Përgjithshme për verifikimin paraprak të të dhënave të pasqyruara në formularin e vetëdeklarimit dhe verifikimit të plotë/thelluar.

Në muajin Prill 2023, KShH kërkoi informacion zyrtar nga tre institucionet kyç<sup>46</sup> që kanë përgjegjësi në administrimin e vetë-deklarimeve të kandidatëve dhe verifikimin e tyre. Nga informacioni i përcjellë nga

---

<sup>43</sup> në Bashkitë Tropojë, Has, Durrës, Tiranë, Himarë dhe Mallakastër

<sup>44</sup> Në datën 12 Maj njëri prej kandidatëve për kryetar bashkie në Dibër, kallëzoi një rast të dyshuar të shitblerjes së votës. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, me anën e një deklaratë zyrtare informoi se: “nuk ka rezultuar asgjë e paligjshme”.

<sup>45</sup> Nëpërmjet ligjit nr. 38/2016, 14.4.2016

<sup>46</sup> Shkresë nr. 251 prot., dt. 07.04.2023 drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme  
Shkresë nr. 253 prot., dt. 07.04.2023 drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Shkresë nr. 252 prot., dt. 07.04.2023 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

ana e Prokurorisë së Përgjithshme, KShH konstaton me shqetësim se asnjë prej partive politike nuk ka ushtruar të drejtën për të kërkuar verifikim të thelluar për kandidatët e mundshëm të tyre, çka bie ndesh me nenin 7 pika 5 të ligjit të sipërcituar. Kjo situatë, përpos mungesës së interesit nga ana e subjekteve politike për të respektuar ligjin, passjell një volum dinamik dhe proces me hapa të ngadaltë e jo efikasë të dekriminalizimit në procesin zgjedhor, për institucionet përgjegjëse, gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe në atë pas zgjedhore.

Në bazë të nenit 8 të ligjit nr. 138/2015 rezulton se KQZ ka kërkuar kryerjen e verifikimit të thelluar nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme ndaj 37 personave,<sup>47</sup> të emëruar dhe kandidat për Kryetar Bashkie e anëtar të Këshillit Bashkiak, prej të cilëve 9 persona kandidat për kryetar Bashkie dhe 17 persona kandidat për anëtarë Këshilli Bashkiak. Pavarësisht masave paraprake të ndërmarra, gjatë periudhës zgjedhore Maj 2023, procesi i verifikimit të të dhënave të pasqyruara në formularët e vetëdeklarimit ende nuk kishte përfunduar, ndërkohë që për shkak të përmbajtjes së të dhënave sensitive ato i bëhen me dije vetëm kërkuarit dhe personit të verifikuar.

Sa i përket procesit të bashkëpunimit ndërkombëtar, në të njëjtën linjë me shqetësimin e Prokurorit të Përgjithshëm<sup>48</sup>, KShH rithekson domosdoshmërinë për forcimin e urave të bashkëpunimit midis autoriteteve proceduese, ligjzbatuese dhe gjyqësore homologe në nivel ndërkombëtar. Nga ana tjetër, bëhet e ditur nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme se shkak për refuzimin e informacionit nga ana e autoriteteve homologe, rezulton të jetë natyra e procedurës së verifikimit, e cila është mirëfilltazi administrative, ndërkohë që Konventa “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” detyron vendet anëtare të bashkëpunojnë vetëm në rastet e një hetimi penal dhe jo për raste të verifikimit administrativ. Vështirësi ndeshen edhe nga KQZ, e cila në kushtet e ngarkesës për administrimin e procesit zgjedhor përballet me një numër të caktuar formularësh vetëdeklarimi, për t’u verifikuar paraprakisht brenda afateve të shkurtra kohore.

Për arsyet e sipërcituara, sa kohë që varet tërësisht nga vullneti shumëpalësh në kuadër të frymës së bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe përgjigjet nga ana e autoriteteve homologe nuk përcillen përpara datës së dekretuar për realizimin e procesit zgjedhor, KShH vëren se procesi i dekriminalizimit mbetet një mekanizëm pjesërisht efektiv në vendin tonë.

## 6. RESPEKTIMI I HESHTJES ZGJEDHORE

---

Vëzhguesit e KShH, të cilët u angazhuan gjerësisht në terren përgjatë ditës së heshtjes zgjedhore<sup>49</sup>, konstatuan shkelje në masë të parashikimeve ligjore të Kodit Zgjedhor. Që prej nisjes së monitorimit, vëzhguesit vunë re materiale statike ende të afishuara në formatin e *billboards*, reklama në stacione

---

<sup>47</sup> Kërkuar më dt. 24.04.2023 dhe 26.04.2023

<sup>48</sup> Intervistë e Prokurorit të Përgjithshëm <https://www.zeriamerikes.com/a/7049101.html>

<sup>49</sup> Neni 77, Pika 2, Kodi Zgjedhor: *periudha e heshtjes zgjedhore formohet nga dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit*

autobuzash, *city lights*, si dhe pamfleta të shpërndara e postera të ngjitur<sup>50</sup>. Gjithashtu fushata dhe sondazhet vijuan në media *online* si dhe në ato sociale si në Bashkitë Pogradec<sup>51</sup> dhe Gjirokastrë<sup>52</sup>.

KShH i bëri thirrje KQZ-së për të urdhëruar Policinë Bashkiake apo të Shtetit për të zbatuar detyrimet ligjore dhe hequr çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore sa më shpejt, përpara ditës së votimit. Pas sinjalizimeve, KQZ mori Vendimin nr. 516, datë 13.5.2023, të Komisionerit, nëpërmjet të cilit ngarkoi Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake përkatëse me heqjen e gjithë materialeve propagandistike nga të gjitha ekranet *led-wall* (*billboards*) në afërsi të KQV-ve, KZAZ-ve dhe VNV-ve. Si rrjedhojë e periudhës shumë të shkurtër gjatë së cilës heshtja zgjedhore aplikohet, KShH vëren se mobilizimi i institucioneve përkatëse duhet të ishte kryer që në orët e para të mëngjesit të datës 13 Maj 2023.

Gjatë Ditës së Votimit, në media sociale është raportuar mbi ndërhyrjen e policisë në kuadër të heqjes së materialeve propagandistike të ndodhura në ambientet e jashtme të selisë së partisë Lëvizja Bashkë, kryetari i së cilës kandidonte për kryetar të Bashkisë Tiranë. Nga vëzhgimet në terren të KShH, rezultoi se kjo ndërhyrje, edhe pse e drejtë në kontekstin ligjor, është kryer në një mënyrë joproporcionale në raport me subjektet e tjera zgjedhore, posterat e fushatës së të cilëve ende vijonin të ishin të afishuar pranë selive të tyre partiake. KShH sërish bëri thirrje që institucionet të funksionojnë duke garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë subjekteve zgjedhore.

## 7. PROCESI I VOTIMIT

---

### A. KLIMA DHE RENDI PUBLIK

Në vijim të polarizimit të fushatës politike, gjatë ditës së votimit u shënuan disa incidente sporadike. Herët në mëngjes, përpara hapjes të procesit të votimit, u shënuua incidenti i parë pranë Bashkisë së Kolonjës<sup>53</sup>. Orët e para të procesit të votimit u pasuan nga ngjarja e rradhës ku procesi i votimit në QV 1430/2 në Bashkinë Durrës u ndërpre për rreth 30 minuta<sup>54</sup>. Më tej, gjatë mesditës, u konstatuan dy incidente të njëpasnjëshme në Bashkinë Fushë-Krujë dhe Maliq<sup>55</sup>. Gjithashtu, në QV 1430/00 (ZAZ 24) Bashkia Durrës, është sinjalizuar incidenti ndërmjet disa shtetasve mes të cilëve kreu i subjektit politik PD dhe këshilltari bashkiak i PS-së. Vëzhguesit e KShH vërejtën se rreth 4 orë më pas, mbështetësit e subjekteve

<sup>50</sup> Bashkia Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Kukës, Lezhë, Pogradec, Korçë dhe Fier

<sup>51</sup> Janë konstatuar publikime të rezultateve të sondazheve herët në mëngjesin e datës 13 maj

[https://www.facebook.com/100070195478664/posts/pfbid038947jVQFiReorYezVZ1fhBfcVm52U824VBdxL35tYHqVngAr\\_dYRL8bDG9LBoyVVrl/?mibextid=cr9u03](https://www.facebook.com/100070195478664/posts/pfbid038947jVQFiReorYezVZ1fhBfcVm52U824VBdxL35tYHqVngAr_dYRL8bDG9LBoyVVrl/?mibextid=cr9u03)

<sup>52</sup> Është raportuar mbi një sondazh që vazhdon ende të ishte i hapur për publikun në lidhje me rezultatin zgjedhor për kryetar bashkie <https://argjirolajm.net/gara-mes-kusherinjve-ne-libohove-leonard-hide-modeli-yne-eshte-i-punes-dhe-veprave-qe-flasin-modeli-i-atyre-eshte-mizerja-dhe-dembelizmi/>

<sup>53</sup> Një simpatizant i subjektit politik PD u raportua mediatikisht se kishte goditur kryebashkiakun e rikandiduar të subjektit zgjedhor “PS”, z. Erion Isai <https://top-channel.tv/2023/05/14/zgjedhjet-nisin-me-dhune-goditet-kryebashkiaku-i-kolonjes-erion-isai-simpatizanti-i-bashke-fitojme-shoqerohet-ne-rajon-emri/>

<sup>54</sup> Si rrjedhojë e një konfrontimi fizik ndërmjet mbështetësve të dy forcave politike dhe sekretarit të KQV-së, të propozuar nga subjekti politik koalicioni “Bashkë Fitojmë”, pas të cilit sekretari u largua duke marrë vullën e tij me vete.

<sup>55</sup> Përkatësisht, në incidentin e parë një votues goditi një prej antarëve të KQV. Ndërkohë, në Bashkinë e Maliqit, deputeti i subjektit politik PD ka rënë preh e një sulmi fizik nga ana e një grupi të rinjsh simpatizantë

<https://www.balkanweb.com/je-i-lidhur-me-bandat-edmond-spaho-goditet-me-grusht-pas-akuzave-per-deputetin-e-ps-kallezim-ne-prokurori-ja-cfare-ndodhi-ne-maliq/>

të ndryshme zgjedhore ishin rikthyer pas shpërndarjes së kryer nga Policia e Shtetit e kërkuar për të vendosur sërish rendin pranë QV-së, duke vendosur në pikëpyetje autoritetin e ndërhyrjes së tyre.

Ndërkohë që disa prej çështjeve të mësipërme i janë referuar Prokurorive të Rretheve Gjyqësore nga Policia e Shtetit, KShH po vijon ndjekjen nga afër dhe analizimin e krimeve zgjedhore të ndodhura përgjatë vitit.

## **B. HAPJA E PROCESIT TË VOTIMIT**

Procesi i votimit, i zhvilluar më datë 14 Maj 2023, u monitorua nga vëzhguesit e KShH në 200 Qendra Votimi, të ngritura në 15 prej Bashkive të Republikës së Shqipërisë. Në një pjesë të konsiderueshme të QV-ve të mbuluara nga vëzhguesit e KShH, procesi i votimit filloi me vonesë si rrjedhojë e keqfunksionimit të Pajisjeve Elektronike të Identifikimit (PEI). Vëzhguesit e KShH raportuan se në plot 26.8% të Qendrave subjekt monitorimi<sup>56</sup>, pajisja kishte shfaqur probleme. Votimi filloi me vonesë, përreth orës 10.00 në disa prej QV-ve, të monitoruara pas publikimit të Vendimit nr. 520, dt. 14.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve<sup>57</sup>, sipas të cilit procesi i identifikimit ju rikthye procedurës manuale.

Ndërkohë, në disa QV të tjera<sup>58</sup> pranë Bashkisë Tiranë, Gjirokastrë, Korçë, Berat dhe Durrës u konstatuan vonesa si rrjedhojë e mungesës së njohurive dhe koordinimit midis anëtarëve të KQV-ve. KShH konstaton se këto mospërputhje të ndodhura në momente të rëndësishme të administrimit të procesit të votimit mund të vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë e pjesëmarrjes së ulët të komisionerëve në trajnime, fenomen i raportuar nga KShH pranë KQZ-së me sugjerimin për marrjen e masave konkrete dhe imediate.

## **C. FUNKSIONIMI I PAJISJEVE TË VOTIMIT ELEKTRONIK**

Në zbatim të Vendimit nr. 22, dt. 01.02.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve<sup>59</sup>, zgjedhjet në tri bashki u zhvilluan në mënyrë elektronike. Nga 20 Qendrat e Votimit të monitoruara nga KShH pranë Bashkisë Elbasan dhe Bashkisë Kamëz, 14 prej tyre u konstatuan me problematika të kategorive të ndryshme. Më kryesorja ishte paqartësia e votuesve për mënyrën e përdorimit të PEVN-së<sup>60</sup> edhe pse të gjithë QV-të e monitoruara ishin të pajisur me postera informues. Paqartësia e votuesve është shoqëruar nga probleme të tjera, si p.sh. votimi familjar ku dy apo tre votues kryesisht të të njëjtës familje qaseshin së bashku pranë pajisjes<sup>61</sup>; mungesa e dokumentimit të ndihmës ndaj zgjedhësve që nuk mund të votojnë vetë<sup>62</sup>, etj<sup>63</sup>.

<sup>56</sup> QV nr. 2077/00 (ZAZ 30), 1827/01 dhe 1827/02, 1828/02, 1829/00 dhe 1829/1 (ZAZ 35), 1857/00, 1857/01 dhe 1857/02 (ZAZ 36), QV 2307/00 (ZAZ 48), QV 4258/01 (ZAZ 80), QV 4240/00, QV 4493/01 (ZAZ 86).

<sup>57</sup> [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Vendimi\\_520\\_230514\\_KSHZ\\_Nenkomisioner.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Vendimi_520_230514_KSHZ_Nenkomisioner.pdf)

<sup>58</sup> QV nr. 2105/00 (ZAZ 29), QV nr. 1858/00 (ZAZ nr. 36), QV nr. 4252/00 (ZAZ 80), QV nr. 3641/00 (ZAZ 74), QV nr. 3273/02 (ZAZ 65), QV nr. 1472/01 (ZAZ 23)

<sup>59</sup> <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-nr.-22-date-1.2.2023-Per-zbatimin-e-projektit-pilot-per-procesin-e-votimit-dhe-numerimit-te-votave.pdf>

<sup>60</sup> QV nr. 2307/48, 2204/02 (Bashkia Elbasan) 1529/00, 1566, 1569/01, 1571/01, 1576, 1600/03 (Bashkia Kamëz)

<sup>61</sup> QV nr. 1529/00 (Bashkia Kamëz)

<sup>62</sup> QV nr. 1600/03, 1569/01, 1576 (Bashkia Kamëz)

<sup>63</sup> Si p.sh. mosarritja e kuptimit të administrimit të votës nga pajisja, konfidoi një qytetar, i cili duke u asistuar nga familjari i tij nuk arriti të kuptonte momentin kur vota u finalizua - QV nr. 1566 (Bashkia Kamëz)

#### D. RREGULLSHMËRIA E PROCESIT TË VOTIMIT

Përgjithësisht, Komisionerët e QV-ve të monitoruara nga vëzhguesit e KShH respektuan procedurat e votimit të parashikuara në nenin 40 të Kodit Zgjedhor, si dhe parashikimet e detajuara në Vendimin nr. 22, dt. 20.04.2023, të Komisionit Rregullator<sup>64</sup>, sa i takon verifikimit të emrit të zgjedhësit në listë, kontrollit të mjetit identifikues ID, nënshkrimit të zgjedhësit në listë, timbrosjes në gishtin e madh të njëjës dorë dhe dhënies së dy fletëve të votimit të vulosura nga mbrapa me dy vula. Ndërkohë, një nga problematikat e vëna re më shpesh nga vëzhguesit e KShH në një numër relativisht të ulët të QV-ve, përfshinte mungesën totale të timbrimit<sup>65</sup> apo ndjekjen e procedurës së gabuar nga anëtarët duke timbrosur gishtin e madh të dorës së djathtë dhe jo atë të dorës së majtë<sup>66</sup>, në mospërputhje me parashikimet e bëra në Nenin 105, pika 1, german “dh” të Kodit Zgjedhor, si dhe në Udhëzuesin e Punës për KQV-të.

Vëzhguesit e KShH gjatë monitorimit të tyre vunë re komunikime të njëpasnjëshme të komisionerëve të KQV-ve me vëzhgues të akredituar të subjekteve politike. Ky komunikim përfshinte ndarjen e të dhënave individuale të votuesve<sup>67</sup> duke e komunikuar me zë të lartë në momentin që këta të fundit identifikoheshin pranë KQV-së. Vëzhguesit e subjekteve politike mbanin formate tabelare të listave të zgjedhësve pranë të cilave shënonin numrat rendorë të zgjedhësve, të cilët votonin<sup>68</sup>, ndërkohë, pranë Bashkive Tiranë<sup>69</sup> dhe Elbasan<sup>70</sup>, janë shfaqur dhe vëzhgues me aplikacione të përshtatshme celulare pranë të cilave kryenin të njëjtin proces. Ky fenomen në disa raste është konstatuar të jetë ndjekur nga procesi paralel i grupimeve të konsiderueshme të individëve të cilët grumbulloheshin në kafene pranë godinave ku ishin vendosur QV-të dhe mbanin shënime në listat e printuara të zgjedhësve. Në vijim, vëzhguesit raportuan se të paktën një pjesë prej këtyre individëve ishin punonjës në administratën publike apo simpatizantë të partive politike. KShH vlerësoi me shqetësim këtë situatë si cënim të të dhënave personale dhe premisa për intimidim të zgjedhësve, ndaj vuri në dijeni menjëherë KQZ-në. KShH nuk ka informacion mbi verifikimet e kryera nga KQZ dhe rezultatet e tyre.

Kodi Zgjedhor, në Nenin 109, pika 6 të tij përcakton se *në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës nuk lejohet prania apo grumbullimi i personave*. Gjithashtu, Komisioneri ka miratuar Urdhërin nr.62, dt. 03.05.2023, i cili ndalon prezencën e personave të paautorizuar në një rreze prej 150m nga godina ku ndodhen Qendrat e Votimit<sup>71</sup>. Përkundrajt parashikimeve të mësipërme, vëzhguesit afatgjatë të KShH raportuan prezencë të personave të paautorizuar, të cilët nuk mbanin në pozicion të dukshëm *badge* të akreditimit, e që vëzhgonin procesin apo qëndronin në ambientet e brendshme (p.sh. korridor, hyrja e godinës) e të jashtme (p.sh. oborri, muret rrethuese dhe kafenetë përreth) të KQV-së<sup>72</sup>. KShH i përcolli këto raportime pranë KQZ-së, duke specifikuar se Komisionerët e QV-ve neglizhojnë ose janë shumë pasivë për të verifikuar ambientet në korridoret dhe oborret e godinave ku janë vendosur personat e paautorizuar. Megjithatë, ka patur edhe

<sup>64</sup> [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Vendim-nr.-22-date-20.4.2023-Per-miratimin-e-udhezuesit-te-punes-per-KQV\\_compressed.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Vendim-nr.-22-date-20.4.2023-Per-miratimin-e-udhezuesit-te-punes-per-KQV_compressed.pdf)

<sup>65</sup> QV 2073, QV 2090/00, QV 3674, QV 2090 (filloi timbrosja pas vërejtjes me shkrim të vëzhguesit të KShH), QV 0037/1

<sup>66</sup> QV 1645/01, QV 1813/02, QV 2092/00

<sup>67</sup> Përgjithësisht numrin e tyre rendor në listën e zgjedhësve të QV-së

<sup>68</sup> QV 1827/1, 1827/2, 1830/1, 1827/2 (Bashkia Tiranë), QV 0734/0, 0737 (Bashkia Lezhë), QV 0652/00 (Bashkia Kukës), QV 1571/01 (Bashkia Kamëz)

<sup>69</sup> QV 1827/1, 1827/2

<sup>70</sup> QV 2376, 2377

<sup>71</sup> [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Urdher\\_62\\_per\\_qv.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Urdher_62_per_qv.pdf)

<sup>72</sup> QV 1429,1430,1430/1(Bashkia Durrës); QV 2099, QV 1828/02 dhe 1829/00, 1937, 1830/1,1905, 2085/00, 1830/1, 1894, 1804/00, 1891/01 (Bashkia Tiranë), QV 0745/02 (Bashkia Lezhë), QV 2307 (Bashkia Elbasan); QV 4246/1 (Bashkia Gjirokastrë); QV 3684/00 (Bashkia Korçë); QV 4493 (Bashkia Vlorë), QV 1592/00, 1596/01 dhe 1574 (Bashkia Kamëz)

disa raste pozitive kur pas evidentimit të prezencës së tyre nga vëzhguesit e KShH, këta individë janë orientuar të largohen<sup>73</sup>.

Njëjtë me proceset e mëparshme zgjedhore, KShH vijon të konstatojë se votimi familjar dhe mosdokumentimi i përshtatshëm, sipas Nenit 108 të Kodit Zgjedhor, i dhënies së ndihmës ndaj zgjedhësve që nuk mund të votojnë vetë mbeten ndër problemet kryesore. Përkatësisht, gjatë Ditës së Votimit, janë konstatuar disa raste shqetësuese të votimit familjar<sup>74</sup>, për të cilat KShH njoftoi menjëherë KQZ-në. Nga ana tjetër, KShH gjithashtu ka konstatuar pozitivisht disa raste sporadike ku KQV-ja veproi në mënyrë të menjëhershme për ta ndaluar procesin e votimit familjar<sup>75</sup>.

Në shumicën e QV-ve pranë të cilave vëzhguesit e KShH-së janë qasur, komisionerët e KQV-së kanë udhëzuar votuesit të vendosin aparatet celularë pranë tavolinave në hyrje të QV-së duke pamundësuar kështu përdorimin e tyre për fotografimin e votës. Megjithatë, vëzhguesit e KShH evidentuan disa raste sporadike në QV-të pranë Bashkive Vlorë dhe Dibër<sup>76</sup>, si dhe disa raste të tjera të tentativës për fotografim në Bashkinë Kukës<sup>77</sup>, duke cenuar parashikimet e nenit 109, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

## **E. AKSESI NË USHTRIMIN E DETYRËS SË VËZHGUESIT**

Vëzhguesit e KShH kanë konfirmuar në 92.8% të rasteve se fushëpamja e tyre në QV ishte e lirë dhe ata mund të konstatojnë lehtësisht veprimtarinë e individëve prezentë. Ndërmjet rasteve të cilët nuk u lejuan të kenë qasje të lirë, qëndrojnë: rasti i vëzhguesit të KShH pranë QV-së 0732/01 në Bashkinë Lezhë, i cili nuk u lejua të qasej në brendësi të QV-së gjatë procedurës së hapjes së saj nga Kryetarja. Në QV-në 3273 pranë Bashkisë Berat, vëzhguesi i KShH u përball me kryetarin e KQV-së, i cili fill pas qasjes së vëzhguesit pranë ambientit, ju drejtua vëzhguesit me një ton të ashpër duke kërkuar largimin e tij prej Qendrës së Votimit, duke pretenduar se nuk ishte lajmëruar për prezencën e tij. KShH konstatoi se një pretendim i tillë nuk ishte i bazuar në ligj, prandaj vëzhguesi i KShH-së vijoi detyrën e tij pranë kësaj KQV-je.

Sërisht në Bashkinë Lezhë, vëzhguesi i KShH i vendosur pranë QV-së 0687 është intimiduar nga vëzhguesi i subjektit zgjedhor të PS, pasi paraqiti një vërejtje me shkrim pranë KQV-së në përputhje me parashikimet e Nenit 7, pika 1, germa “b” të Kodit Zgjedhor<sup>78</sup>.

<sup>73</sup> QV 3669/1 (Bashkia Korçë); QV 4246/1 (Bashkia Gjirokastër); QV 0636/00 (Bashkia Kukës)

<sup>74</sup> Bashkia Malësi e Madhe (QV 0737, QV 0687, QV 0025), Bashkia Kukës (QV 0648/00), Bashkia Dibër (QV 1176, QV 1142), Bashkia Lezhë (QV 0687, QV 0737/0 2 raste), Bashkia Elbasan (QV 2322), Bashkia Kamëz (QV 1592/00, QV 1569/00 2 raste, QV 1566, QV 1572, QV 2074/00; QV 1598), Bashkia Berat (QV 3273; QV 3311), Bashkia Pogradec (QV 3885), Bashkia Vlorë (QV 4459)

<sup>75</sup> P.sh. QV-0238 (Bashkia Shkodër) dhe QV 3898/02 (Bashkia Pogradec). Ndërkohë në QV-3885 (Bashkia Pogradec), KQV-ja e ndaloi shkeljen vetëm pasi u depozitua vërejtje me shkrim nga vëzhguesi i KShH

<sup>76</sup> QV-4459; QV-1142

<sup>77</sup> QV-0645 - Në këtë QV më tej është ndjekur praktika e moslejimit të qasjes së vëzhguesve me aparat celular në brendësi të QV-së.

<sup>78</sup> KQV-ja ka zgjedhur të mos e protokollojë, duke ja dorëzuar vërejtjen një vëzhguesi prezent të subjektit zgjedhor PS, i cili e ka fotografuar vërejtjen dhe dërguar në WhatsApp. Vëzhguesi i subjektit zgjedhor PS i është drejtuar vëzhguesit të KShH, duke i përmendur se ky është rasti i dytë që vëzhguesi po krijon situata nëpërmjet depozitimit të vërejtjes me shkrim. Në këto kushte, vëzhguesi i KShH është ndjerë i intimiduar dhe është larguar nga kjo Qendër Votimi, pasi tone të ashpra e të larta janë përdorur ndaj tij. KShH njoftoi menjëherë mbi këtë rast KQZ.



## **F. MBYLLJA E PROCESIT TË VOTIMIT**

Në përputhje me Nenin 11, pika 1 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon orën 19.00 për mbylljen e procesit, të gjitha QV-të e monitoruara nga KShH në këtë proces zgjedhor u mbyllën në kohë. Atmosfera e mbylljes së QV-ve ishte kryesisht e qetë dhe pa incidente, pasi nuk pati zgjedhës në rradhë të cilët do të kërkonin të votonin.

## **8. PROCESI I NUMËRIMIT**

---

### **A. KLIMA E PËRGJITHSHME E PROCESIT**

Në vijim të mbylljes së procesit të votimit për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, vëzhguesit e KShH vijuan monitorimin e pjesshëm të procesit të numërimit në 20 VNV, të vendosura pranë godinave të KZAZ-ve, në 13 Bashki të vendit<sup>79</sup>. Të gjitha VNV-të ishin të vendosura pranë godinave publike dhe ishin pajisur me kamera, të cilat ishin drejtuar ndaj tavolinave dhe transmetonin drejtpërdrejt procesin pranë selisë qendrore të KQZ-së. Përgjithësisht, në tërësinë e VNV-ve të monitoruara procesi i dorëzimit të kutive u krye konform afateve dhe procedurave të detajuara në Nenin 115 të Kodit Zgjedhor. Procedurat e vetme të zgjatura u konstuan pranë VNV-së nr. 13 të Bashkisë Lezhë dhe VNV-së nr. 47 të Bashkisë Elbasan, si rrjedhojë e largësisë së disa prej Qendrave të Votimit. Njëkohësisht, pranë të gjithë VNV-ve objekt monitorimi është konstatuar zhvillimi i trajnimeve të momentit të fundit, një praktikë e evidentuar dhe më herët nga KShH si shumë e dëmshme.

### **B. RREGULLSHMËRIA E PROCESIT TË NUMËRIMIT**

Në përputhje me parashikimet e bëra në Nenin 95 të Kodit Zgjedhor, çdo tavolinë e numërimit kishte në dispozicion dy Grupe të Numërimit të Votave të përbërë nga 4 persona. Prezent në çdo moment pranë tavolinave të numërimit ishte vetëm një prej GNV-ve. Në VNV nr. 01, Bashkia Malësi e Madhe, vëzhguesi i KShH raportoi se tre prej katër tavolinave po numëronin me tre anëtarë dhe jo me katër në shkelje të Nenit 95 të Kodit Zgjedhor.

Të gjithë vëzhguesit kanë pohuar se kanë patur qasje të plotë dhe të pandërprerë ndaj ekraneve tek të cilat shfaqen fletët e votimit. Nga vëzhguesit pranë VNV-së 69, Bashkia Pogradec dhe VNV-ve nr. 35 dhe 39, Bashkia Tiranë, është konstatuar se një pjesë prej vëzhguesve të cilët mund të uleshin larg pengoheshin nga vëzhguesit të cilët qëndronin afër monitorëve në fushëpamjen e tyre.

Konstatimi i prezencës së personave të paautorizuar ka vijuar të jetë problematik në shumicën prej VNV-ve të monitoruara<sup>80</sup>, në brendësi të të cilave janë konstatuar në masë persona të cilët nuk mbanin të varur në një pozicion të dukshëm akreditimet e tyre.

---

<sup>79</sup> Përkatesisht në Malësinë e Madhe, Shkodër, Lezhë, Dibër, Kukës, Tiranë, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Fier, Berat Korçë dhe Pogradec

<sup>80</sup> VNV nr. 01 (Bashkia Malësi e Madhe), VNV nr. 11 (Bashkia Kukës), VNV nr. 12 dhe 13 (Bashkia Lezhë), VNV nr. 35 dhe 39 (Bashkia Tiranë), VNV nr. 65 (Bashkia Berat), VNV nr. 69 (Bashkia Pogradec), VNV nr. 73 dhe 74 (Bashkia Korçë), VNV nr. 80 (Bashkia Gjirokastrë), VNV nr. 83 (Bashkia Vlorë)

Vëzhguesit e KShH, përpos miratimit të Urdhërit nr. 71, dt. 15.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve<sup>81</sup>, kanë konstatuar se procesi i numërimit është pezulluar për disa orë në disa prej VNV-ve të monitoruara<sup>82</sup>.

### **C. NUMËRIMI ELEKTRONIK PRANË BASHKISË ELBASAN**

KShH shtriu vëzhgimin e tij pranë katër GNV-ve të Bashkisë Elbasan, ku u pilotua procesi elektronik i numërimit të votave. Prosesi i numërimit u krye tërësisht elektronikisht, ndërkohë që të dhënat i transmetoheshin drejtpërsëdrejti KZAZ-së përkatëse. I tërë procesi i numërimit elektronik u krye nga operatorët e KQZ-së, të cilët hapën valixhet mbajtëse të PEVN-ve, kryen transmetimin e të dhenave, dokumentuan procesin nëpërmjet procesverbaleve përkatës dhe printuan tabelat finale të rezultateve për çdo QV. KZAZ-të nr. 48, 49 dhe 50 finalizuan procesin e numërimit brenda afatit kohor prej tre orësh, ndërkohë që procesi pranë KZAZ-së nr. 47 u mbyll pak pas orës 3 të mëngjesit.

### **D. KLASIFIKIMI I VLEFSHMËRISË SË VOTAVE**

Në përputhje me Nenin 117 dhe 118 të Kodit Zgjedhor, GNV-të kanë detyrimin për të vlerësuar vlefshmërinë e votave. KShH, nëpërmjet vëzhguesve konstatoi disa çështje sporadike, e megjithatë shqetësuese, të vlerësimit jo të saktë të vlefshmërisë së votave nga GNV-të. Më konkretisht, ndër fletët e votimit të cilat janë konsideruar të pavlefshme përfshihen: (1) Fletë votimi në të cilën janë vendosur shenja dalluese në brendësi të vendit të përcaktuar nga fleta e votimit për dy apo më tepër kandidatë/subjekte zgjedhore; (2) Fletë votimi në të cilat nuk është vendosur shenja dalluese në asnjë prej vendeve të përcaktuara për kandidatët/subjektet zgjedhore; (3) Fletë votimi në të cilat është shënuar një shenjë dalluese e vetme e cila prek hapsirën e të paktën dy kandidatëve; (4) Fletë votimi në të cilat janë shënuar shenja ofenduese përbri emrit; (5) Fletë votimi në të cilën është shënuar fjalë (“Po”, “Pro”, “Fitore”) në brendësi të vendit të përcaktuar nga fleta e votimit; (6) Fletë votimi në të cilën është vendosur shenja dalluese e votimit ngjitur me apo mbi numrin rendor të kandidatit; (7) Fletë votimi në të cilat është vijëzuar, qarkuar apo shënuar emri i kandidatit.

Sa më sipër, në VNV-të nr. 01 (Bashkia Malësi e Madhe) dhe VNV nr. 35 (Bashkia Tiranë), vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar një keqkuptim masiv nga ana e anëtarëve të GNV-ve mbi vlerësimin e votave dhe kategorizimin e tyre në të vlefshme e të pavlefshme. Referuar sesioneve trajnuese të anëtarëve të GNV-ve, të ndjekura nga vëzhguesit e KShH-së, anëtarët e GNV-ve rezultojnë se janë udhëzuar se pikat 5, 6, dhe 7 të lart përmendura janë shprehje të qarta të vullnetit të zgjedhësit dhe, kështu, duhet të konsiderohen fletë votimi të vlefshme, pa qenë e nevojshme që të rikthehen në monitor. Ky udhëzim rezultoi se nuk është respektuar nga ana e anëtarëve të GNV-ve.

### **E. MBYLLJA E PROCESIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE**

Në tërësi, KShH vlerëson ritmet e shpejta të procesit të numërimit, ndërkohë që brenda 24 orëve të para rezultoi se GNV-të e rreth 50 bashkive nga 62 në total kishin përfunduar procesin e numërimit. Tri bashkitë e para të cilat përfunduan procesin e numërimit dhe shpallën rezultatin e zgjedhjeve ishin përkatësisht Kamza, Vora dhe Elbasani, ku u pilotua procesi i votimit dhe numërimit elektronik. Këto u

<sup>81</sup> [https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Urdher\\_nr\\_71\\_230514\\_KZAZ\\_per\\_numerimin\\_pa\\_nderprerje.pdf](https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Urdher_nr_71_230514_KZAZ_per_numerimin_pa_nderprerje.pdf)

<sup>82</sup> VNV nr. 1 (Bashkia Malësi e Madhe), VNV nr. 02, 03, 04, 05 (Bashkia Shkodër), VNV nr. 11 (Bashkia Kukës), VNV nr. 12 dhe 13 (Bashkia Lezhë), VNV nr. 19 (Bashkia Dibër), VNV nr. 35 dhe 39 (Bashkia Tiranë), VNV nr. 59 (Bashkia Fier), VNV nr. 80 (Bashkia Gjirokastrë)

pasuan kryesisht nga bashkitë me popullatë të ulët, deri në shpalljen e rezultatit të Bashkisë Lushnje. Tre bashkitë të cilat përmyllën procesin e numërimit për kryetarët e bashkisë në rang vendi, vetëm pas mesditës së datës 17 maj 2023 ishin Bashkia Tiranë, Malësi e Madhe dhe Kukës. Përgjithësisht, mbyllja e procesit u karakterizua nga qetësi dhe KZAZ-të dërguan rezultatet përfundimtare pranë KQZ-së në përputhje me Nenin 122, por në disa raste pa respektuar afatet kohore të vendosura prej këtij Neni.

## 9. SHPALLJA E REZULTATEVE DHE ANKIMIMET

---

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nga data 25.05.2023 e deri më 01.08.2023<sup>83</sup> ka dhënë mandatet për Kryetarët e zgjedhur të Bashkive, në përputhje me parashikimet e kryera në Nenin 166 të Kodit Zgjedhor. Prej datës 22.05.2023 deri më 01.08.2023, KAS ka marrë një total prej 63 vendimesh, prej të cilëve 12 janë vendime për kthim për plotësim të kërkesave ankimore, 6 për pushim të shqyrtimit të kërkesës ankimore, 9 për mospranimin për shqyrtim, 17 për pranimin për shqyrtim, 16 për shqyrtim kërkesë dhe 3 për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore.

Ndërmjet vendimeve nëpërmjet të cilave kërkesat ankimore janë pushuar apo nuk janë marrë në shqyrtim, kjo ka ndodhur si rrjedhojë e provave të pasakta dhe argumenteve të pabazuara në ligj<sup>84</sup>.

KShH ka parë me rëndësi trajtimin e Vendimit nr. 174, dt. 06.06.2023, të KAS<sup>85</sup>, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 531, datë 18.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, si dhe miratimin e Tabelës së re Përmbledhëse, pas rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në të gjitha qendrat e votimit të zonës zgjedhore, bashkia Rrogozhinë. Pretendimi më i rëndësishëm, në këndvështrimin e KShH, ishte rezultati i QV-së nr. 2224/01, të ngritur pranë IEVP Rrogozhinë, i cili kaloi kandidatin e subjektit PS në avantazh. KShH vëren se sipas Vendimit nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese, ngritja e QV-së dhe votimi i të burgosurve pranë IEVP-së Rrogozhinë është kryer në mënyrë ekstraligjore, duke qënë se ky proces zgjedhor ka pasoja të drejtpërdrejta në qeverisjen vendore, e jo atë qendrore. Kësisoj, votimi i individëve të burgosur, të cilët nuk janë banorë në Bashkinë Rrogozhinë, do të ishte i padrejtë, duke qënë se qëndrimi i tyre nën juridiksionin e kësaj Bashkie është i përkohshëm. Gjithsesi, KShH mbështet sugjerimet e bëra nga Avokati i Popullit se privimi nga e drejta e votës i kujtdo individ është tërësisht i padrejtë, kështu KShH propozon ndryshimet e menjëhershme të parashikimeve ligjore, si dhe marrjen e masave për të garantuar votimin e të burgosurve për njësitë e qeverisjes vendore të cilave ata i përkasin si banorë. Vendimi final për këtë çështje u mor nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i cili urdhëroi përsëritjen e procesit zgjedhor në këtë bashki, duke u bazuar në jolegjimitetin e procesit në QV-në e ngritur pranë IEVP-së Rrogozhinë.

Në kuadër të kësaj çështje, KShH drejtoi kërkesa për informacion ndaj tri institucioneve, përkatësisht Bashkisë Rrogozhinë, KQZ dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), në përgjigje të së cilave KShH u njoh me korrespondencën shkresore të këtyre institucioneve mbi mosngritjen e qendrës së

---

<sup>83</sup> Si rrjedhojë e Zgjedhjeve të Përsëritura në Rrogozhinë

<sup>84</sup> Për shembull Vendimi nr. 160, dt. 25.05.2023; Vendimi nr. 135, dt. 24.05.2023, Vendimi nr. 149, dt. 26.05.2023

<sup>85</sup> <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/06/Vendim-nr.-174-date-06.06.2023-Shqyrtim-K.A-80-Rrogozhine-BF.pdf>

votimit<sup>86</sup>. KShH vëren se në përgjigjet e KQZ ndaj pyetjeve të drejtuara nga DPB në lidhje me ngritjen e QV-së së sipërcituar, është mbajtur qëndrimi institucional se ngritja e QV-ve nuk është kompetencë as e KZAZ-së dhe as e KQZ-së, dhe në çdo rast duhet të marrë në konsideratë urdhërimet e Vendimit nr. 28 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Ky i fundit shprehet se sipas Kodit Civil, institucionet e ekzekutimit të vendimit penal janë vendqëndrim e jo vendbanim i të burgosurve, si dhe që sipas Vendimit nr. 40, dt. 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese, të burgosurit duhet të jenë banorë në zonën ku vuajnë dënimin. KShH vëren se vetëm një prej të burgosurve në IEVP Rrogozhinë (nga 89 të dënuar të akomoduar pranë saj) është banor me të drejtë vote specifiku për këtë bashki<sup>87</sup>. Rrjedhimisht duke qenë se pranë kësaj IEVP-je nuk ka të paktën 15 zgjedhës me të drejtë vote për Bashkinë e Rrogozhinës, nuk plotësohet kriteri i kërkuar ligjor për ngritjen e QV në institucione të posaçme sikurse është IEVP Rrogozhinë, i parashikuar në nenin 62 pika 2 të Kodit Zgjedhor.

## REKOMANDIME

---

1. KShH ripërsërit rekomandimin e tij prej zgjedhjeve të kaluara se reforma e mëtejshme zgjedhore kërkon konsensus dhe dialog të gjerë politik, transparencë dhe gjithëpërfshirje. Është e nevojshme të merren në shqyrtim rekomandimet e OSBE/ODIHR-it të pasqyruara në raportet e viteve të fundit. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor nuk duhet të jenë monopol i partive politike dhe as të realizohen në periudha të afërta zgjedhore, por të marrin në konsideratë standartet dhe praktikën e mira ndërkombëtare. KShH rekomandon shmangien e konsultimeve formale në reformimin e ardhshëm zgjedhor përkundrejt nevojës për realizimin e dëgjësive efektive me ekspertët, si dhe organizatat dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.
2. Zgjedhjet e 14 Majit vërtetuan edhe një herë se antarët e Komisioneve Zgjedhore lokale, në mjaft raste, profesionalisht nuk ishin në nivelin e duhur. Në punën e tyre u vërejt edhe njëanshmëria partiake, prandaj qëndron nevoja imediate për të marrë në shqyrtim Rekomandimin prioritar e të hershëm të OSBE/ODIHR-it, po dhe KQZ-së, për depolitizimin total të tyre.
3. Në pilotimin e votimit dhe numërimit elektronik u vërejtën defekte të rëndësishme edhe pse KQZ-ja ka deklaruar se ato nuk patën pasojë. E njëjta gjë është vërtetuar edhe në zgjedhjet e mëparshme. Ndërkohë që numërimi elektronik evidentoi avantazhet e shpejtësisë dhe efikasitetit të tij në raport me numërimin manual, i cili (ky i fundit) u realizua krahasimisht më shpejt në raport me vitet e kaluara. Për problematikat e shfaqura, KShH sugjeron që ky problem të analizohet nga specialistë me përvojë dhe të paanshëm edhe për faktin e shpenzimeve të konsiderueshme. KShH i sugjeron KQZ-së të vendosë në lëvizje mekanizmat e brendshëm apo të jashtëm (me anë të organeve të drejtësisë) të hetimit të përgjegjësive lidhur me këto defekte.
4. Nga një proces zgjedhor në tjetrin vërtetohet e njëjta shkelje: zgjedhësit nuk njoftohen në banesat e tyre për shkak të mungesës së fondit që duhet të akordohet nga Ministria e Brendshme. KQZ-ja, megjithëse në dijeni për këtë, nuk ka ndërhyrë në mënyrë të efektshme për të parandaluar këtë shkelje ligjore. Duke patur parasysh se koha në dispozicion për këtë njoftim është mjaft e shkurtër, KShH sugjeron: a) Fondi të jepet fill pas hartimit dhe publikimit të listave të zgjedhësve dhe b) Njoftimi në banesa të vazhdojë dhe pas publikimit të listave përfundimtare zgjedhore

---

<sup>86</sup> Referuar komunikimeve që ka kryer Drejtoria e IEVP Rrogozhinë me Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë si dhe Komunikimi që ka patur Zv.Drejtori i Përgjithshëm i Burjeve me KQZ-në. Burim informacioni: shkresa kthim përgjigje e Drejtorisë së Përgjithshme të Burjeve drejtuar KShH-së me nr.prot 9912/1, dt.08.08.2023.

<sup>87</sup> Referuar shkresës kthim përgjigje të Bashkisë Rrogozhinë, drejtuar KShH-së, në dt. 08.08.2023, me nr.prot 2647/1

5. KShH rekomandon rishikimin e ligjit nr. 8580, dt. 17.02.2002, konkretisht në nenin 19/2, i cili parashikon shpërndarjen e ndihmës financiare për partitë politike, duke vendosur që partitë plotësuese të njërit prej kriterëve të përcaktuara në ligj, të mos mundet që të jenë gjithashtu përfituese nën kriteret e tjera. Kështu KShH rekomandon që kjo dispozitë të parashikojë kriteret e qarta dhe objektive që mundësojnë një shpërndarje më të drejtë e proporcionale të fondeve publike midis partive politike.
6. KShH vëren se formulimi i nenit 91 të Kodit Zgjedhor është i diskutueshëm pasi lehtëson pozitën e partive politike që fillojnë më herët fushatën zgjedhore. Kjo për arsye se përmbajtja e kësaj dispozite (pika 2 dhe 3 e nenit 91) sanksionon ndalimin e përdorimit të burimeve publike gjatë fushatës zgjedhore (e cila edhe pse ligjërisht fillon një muaj para zgjedhjeve, *de facto* fillon më herët). Kjo është arsyeja se përse ndalimi i përdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale, vlerësojmë se duhet të rishikohet në parashikimet e Kodit Zgjedhor duke e shtrirë këtë ndalim që prej datës së dekretimit të zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe mos e kufizuar atë në raport me faktin nëse një parti politike është regjistruar apo jo si subjekt zgjedhor.
7. Televizionet, sipas parashikimit të Nenit 80 pika 1 mbi radiotelevizionin publik dhe Nenit 84 për radiot dhe televizionet private, të Kodit Zgjedhor, i kanë kushtuar një fraksion kohor minimal subjekteve zgjedhore të cilat janë parti joparlamentare apo kandidatë të propozuar nga zgjedhësit. Këto dispozita vlen të rishikohen, me qëllim që të garantojnë raportim mediatik pluralist dhe gjithëpërfshirës për subjektet garuese.
8. Kryesisht në edicionet informative, KShH vijon të konstatojë me shqetësim se materialet audio-vizuale të regjistruara nga partitë politike apo kandidatët përbëjnë pjesën dërrmuese të materialeve të shfaqura në televizion, në përputhje me Nenin 84/1 të Kodit Zgjedhor, i cili legjitimon transmetimin e tyre. KShH rekomandon rishikimin e këtij neni në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR, me qëllim që t'i jepet fund kësaj praktike që cënon lirinë e medias dhe të drejtën e publikut për t'u informuar me paanshmëri.
9. Afati për verifikimin e integritetit të kandidatëve është relativisht i shkurtër, gjë që pamundëson Prokurorinë e Përgjithshme të bëjë verifikimet përkatëse. Prandaj sugjerojmë që me ligj subjektet zgjedhore të detyrohen që emrat e kandidatëve potencialë t'ju dërgohen për verifikim Prokurorisë së Përgjithshme një muaj përpara se ato t'i paraqiten KQZ-së.
10. KShH i rekomandon KQZ-së që të realizojë hetime administrative të shpejta, efikase dhe objektive të rasteve apo sinjalizimeve të lidhura me shpërdorimin e aseteve publike, si dhe të aplikojë sanksione proporcionale dhe të drejta që i shërbejnë parandalimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, duke treguar rigozitet në zbatimin e ligjit dhe sanksionimin e shkelësve konform nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe akteve rregullatore të saj.
11. Në Kodin Zgjedhor bëhet fjalë për fushatën e ligjshme një mujore. Subjektet zgjedhore në fakt e fillojnë fushatën shumë kohë para fushatës së ligjshme. Kjo përqëndrohet në Kryetarët e Partive. Një praktikë e tillë jo vetëm shoqërohet me shpenzime të shumta që ja kalojnë fushatës së ligjshme, por krijojnë pabarazi të theksuar për partitë më të vogla. KShH sugjeron që KQZ-së në raste të tilla t'i jepet kompetencë jo vetëm të ndërhyjë, por kur është e nevojshme të zbatojë dhe sanksione.
12. Edhe në Zgjedhjet e 14 Majit 2023 vazhdon fenomeni i shëmtuar dhe i dënueshëm i shitblerjes së votës, si dhe kryerja e veprave të tjera penale, gjithaq serioze, në fushën e zgjedhjeve. KShH sugjeron: a) që t'i jepet përparësi hetimit të plotë, të gjithëanshëm dhe objektiv (e jo selektiv) të çështjeve të tilla si rrjedhojë e ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në besimin e elektoratit në proceset demokratike; b) të bëhen analiza lidhur me rrethanat dhe kushtet e kryerjes së veprave të tilla dhe të publikohen ato që do të kishin efekt parandalues.
13. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi përsëritjen e procesit zgjedhor në Bashkinë Rrogozhinë, duke argumentuar njëkohësisht për mosngritjen e QV-së pranë IEVP Rrogozhinë, duke u mbështetur në

parashikimet e Kodit Civil dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. KShH sugjeron marrjen e masave për të siguruar ushtrimin e të drejtës së votës për secilin të burgosur për njësinë e pushtetit vendor, të kushtëzuar në vendbanimin e përhershëm të të burgosurit (Bashkinë përkatëse), duke mos i privuar kështu ata nga ushtrimi i kësaj të drejte themelore.

## **FALENDERIME**

---

KShH falenderon bashkëpunëtorët e tij, pa kontributin e rëndësishëm të së cilëve, hartimi i këtij raporti do të ishte i pamundur.

Znj. Enegrida Bënja, Asistente Projektsh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Z. Albert Vorfaj, Vëzhgues Afatgjatë, Bashkia Lezhë

Znj. Elira Kadriu, Vëzhguese Afatgjatë, Bashkia Tiranë

Z. Ervin Bunjaj, Vëzhgues Afatgjatë, Bashkia Malësi e Madhe

Znj. Evisa Biba, Vëzhguese Afatgjatë, Bashkia Kukës

Z. Florian Duraj, Korrespondent Lokal, Bashkia Fier

Znj. Gentiana Lili, Korrespondente Lokale, Bashkia Gjirokastrë

Znj. Keti Qirinxhi, Korrespondente Lokale, Bashkia Korçë

Z. Klajdi Mone, Korrespondent Lokal, Bashkia Vlorë

Znj. Lunada Hamzi, Korrespondente për Vëzhgimin e Procesit Zgjedhor, Bashkia Shkodër

Znj. Matea Rexhepi, Vëzhguese Afatgjatë, Bashkia Berat

Z. Mateo Yskollari, Vëzhgues Afatgjatë, Bashkia Pogradec

Z. Nikolin Muçaj, Vëzhgues Afatgjatë, Bashkia Tiranë

Znj. Rovena Mullaj, Vëzhguese Afatgjatë, Bashkia Durrës

Znj. Sidorela Horeshka, Vëzhguese Afatgjatë, Bashkia Dibër

Z. Ymer Leksi, Korrespondent Lokal, Bashkia Elbasan